



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Kuvendi Komunal Rahovec/Skupština Opštine Orahovac/Municipal Assembly Rahovec



PROCESVERBAL

Nga mbledhja e KK të Rahovecit, të mbajtur më 12.09.2011, me fillim në ora 10, në sallën e KK Rahovec. Të pranishëm: këshilltarët, kryetari dhe nënkryetari i Komunës, drejtorët e drejtorive, përfaqësuesit e KFOR-it, OSBE-së, KDI, BIRK dhe mediat. Mbledhjen e ka udhëhequr z.Kujtim Popaj, kryesues dhe për këtë mbledhje ka propozuar

REND DITE

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara,
2. Shqyrtimi i Raportit të Kryetarit të Komunës për situatën ekonomike financiare të Komunës dhe zbatimin e planeve investuese për periudhën gjashtëmujore janar-qershor 2011,
3. Informatë nga Drejtoria e Arsimit mbi përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor 2011/2012,
4. Shqyrtimi i kërkesës së Fadil dhe Milaim Musli Paçarizi nga Rahoveci për dhënie në shfrytëzim të një pjesë të ngastrës ndërtimore nr. 1355/4 në pronësinë shtetërore,
5. Shqyrtimi i kërkesës së Adem Hasaj nga Rahoveci për ndarjen në shfrytëzim të ngastrës kadastrale nr. 2240/43 në pronësinë shtetërore,
6. Pyetjet e këshilltarëve.

Fehmi Hoxha – mungon procesverbali i mbledhjes së kaluar sepse mbledhja e kaluar është shtyrë për sot.

Nahit Elshani – meqenëse ne kemi pasur një seancë të jashtëzakonshme në të cilën kemi shprehur shqetësimet dhe kundërshtimet tona sa i përket Projektligjit për fshatin Hoçë e Madhe dhe ne e dimë që ai Projektligj ka kaluar leximin e parë, por është mirë që të paktën edhe sot të japim mendimin tonë për këtë Projektligj.

Salih Hoti – pajtohem me propozimin e Nahitit, kjo pikë të mbahet e para dhe të jemi sa më të shkurtër dhe sa më konkret.

Kryesuesi – kemi propozimin që të jetë edhe një pikë e rendit të ditës dhe të jetë pikë e parë – diskutimi lidhur me Projektligjin e Hoçës së Madhe. Kush është që të hyjë edhe kjo pikë në rend të ditës? Të gjithë. Me këtë plotësim rendi i ditës për mbledhjen e sotme është aprovuar.

1. Projektligji për Hoçën e Madhe.

Smajl Latifi, kryetar i Komunës – ju informoj se Projektligji për H. Madhe ka kaluar në Kuvendin e Kosovës me një diferencë të vogël të votave. Kryesia e Kuvendit të Kosovës e ka paraparë që të jetë pika e fundit e rendit të ditës dhe atë ditë kam qenë edhe vetë me bashkëpunëtorët e mi në Parlamentin e Kosovës. Kur është diskutuar për Hoçën e Madhe nuk ka pasur prani të mediumeve dhe në parim ky Projektligj ka kaluar. Nuk ka ndryshuar në esencë nga varianti të cilin ju e keni diskutuar në mbledhjen e Asamblesë komunale përveç disa ndryshimeve të vogla siç është te “këshilli i fshatit” tani është “komiteti i fshatit”. Ne si Qeveri dhe personalisht jam kujdesur që ti artikuloj, t’i dërgoj shqetësimet dhe të mbajmë pozicionin tonë si institucione komunale edhe para grupeve parlamentare të cilat marrin pjesë në Kuvendin e Kosovës, i kemi dërguar shqetësimet tona edhe me letër të gjithë shefave të grupeve parlamentare, kryetarit të Kuvendit të Kosovës. Me pozicionin tonë janë në dijeni edhe Qeveria e Republikës së Kosovës dhe ministri i MPHMM. Ne jemi përpjekur maksimalisht që të bëjmë punën tonë si institucione komunale, si njerëz të institucioneve dhe jemi munduar maksimalisht që të mbajmë një pozicion të drejtë, të qartë dhe të vendosur se fshati H. Madhe nuk ka nevojë që të ketë një Ligj i cili mund të shkaktoj implikime të rënda dhe të cenoj dhe vështirësoj në masë të madhe jetën dhe angazhimin e institucioneve të Komunës së Rahovecit. I kam dërguar edhe shqetësimet të cilat janë adresuar pikërisht në këtë Kuvend, madje edhe procesverbalin e seancës së Kuvendit kur është diskutuar për këtë pikë dhe po ashtu të gjithë jemi dakord dhe kemi pozicionin unanimit ku kemi shprehur mospajtimin tonë të thellë dhe kundërshtimin tonë të arsyeshëm, të bazuar në argumente e fakte pse nuk ka nevojë që të ketë Hoça e Madhe ligj. Këto ditë kam marr informata edhe prej gjeodetëve ku sipërfaqja apo zona kadastrale e Hoçës së Madhe përfshin 1.352,48 ha, është zona më e

madhe pas qytetit të Rahovecit në Komunë. Ne duhet të jemi shumë të përgjegjshëm dhe të vendosur që këtë çështje të mos e lëmë në heshtje, por të bëjmë punën tonë si duhet pavarësisht që ligji ka kaluar në parim në leximin e parë dhe pas gjashtë muajve duhet me u amandamentue, pavarësisht që ky Ligj nuk do të hyjë në fuqi më 2012 por llogaritet që të zbatohet në viti 2015. Në këtë drejtim ne duhet të jemi shumë të gatshëm me dhënë kontributin tonë, qoftë në drejtim të mospajtimit me këtë Ligj, qoftë në drejtim të adresimit të shqetësimeve dhe kërkesave, nevojave tona të cilat do të ndikojnë që Kuvendit të Kosovës të mos i jepet mundësia që në të ardhmen të na ofroj këtë produkt i cili bie ndesh edhe me qëndrimet tona dhe me orientimet tona zhvillimore por edhe me strategjinë që e kanë në përgjithësi institucionet e Komunës së Rahovecit, po aq më keq bjen në kundërshtim me aspiratat dhe qëllimet e qytetarëve të Rahovecit për një jetë të qetë dhe normale. Unë jam i gatshëm që bashkë me juve të kontribuojmë në vazhdimësi që të vështirësohet zbatimi i një Ligji i cili edhe ashtu po mendojmë që është i pazbatueshëm, është vështirë i zbatueshëm në Komunën e Rahovecit. Ne i kemi tashmë edhe reagimet e Shoqërisë civile siç i kemi reagimet e këshilltarëve të forcave politike dhe të gjitha institucioneve të Komunës, kështu që unë fare nuk besoj që ky ligj mund të implementohet.

Nahit Elshani – sa i përket Ligjit për fshatin e Hoçës së Madhe, meqenëse është një ligj i cili buron nga pakoja e Ahtisarit, është mirë që ne si këshilltarë komunal të dalim me propozime konkrete të cilat kishin me u amandamentue në këtë Ligj. Ky propozim i Kuvendit komunal t’i adresohet deputetëve të Parlamentit të Kosovës. Këtë po e them për faktin se Ligji ka kaluar leximin e parë, po ashtu meqenëse pakoja e Ahtisarit është pakoja e cila është pranuar nga Kosova dhe ligjet që dalin nga ajo në një mënyrë nuk mund të kundërshtohen, mund të kundërshtohen por janë të aprovueshme në Parlamentin e Kosovës. Atë ditë kur është aprovuar në parim Ligji për Hoçën e Madhe shumë thjeshtë mund të ndodhë që edhe ë leximin e dytë të kalojë. Atë që ne si grup i këshilltarëve propozojmë është që ky Ligj, i cili është diskriminues, i cili e cenon territorin e Komunës dhe i cili vënë nën mbrojtje një zonë kadastrale të një fshati që është zonë më e madhe pas qytetit të Rahovecit, të ndryshojë dhe me Ligj të rregullohet mbrojtja e objekteve me rëndësi kulturore historike dhe fetare në Hoçë të Madhe, vetëm territori i objekteve me rëndësi kulturore historike të cilat gjenden në fshatin e Hoçës së Madhe, por jo edhe zona kadastrale. Këtë po e them për faktin se kjo e pamundëson zhvillimin ekonomik lokal të Komunës, po ashtu e pengon lëvizjen e lirë dhe do të jetë pengesë për zhvillimin e tërësishëm të Komunës. E cenon edhe Ligjin mbi vetëqeverisjen lokale që është në kundërshtim të plotë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe është një çështje që duhet të kërkohet të ndryshohet. Çështja e dytë është që ky Komitet prej 5 anëtarëve të emërohet nga Kuvendi komunal në bashkëpunim me banorët e fshatit Hoçë e Madhe e jo të zgjidhet me vota të drejtpërdrejta sepse nëse shkohet me zgjedhjen e votave të drejtpërdrejta bie në kundërshtim me LVL. Çështja e tretë që po ashtu konsiderojmë që duhet ndryshuar që Kisha ortodokse serbe të mos jetë pjesë e këtij Komiteti, për faktin se nuk duhet lejuar involvimin e institucionit fetar në institucionet qeverisëse komunale. Këto janë 3 çështje të cilat është mirë ne të kërkojmë që të ndryshohen, përndryshe ky Ligj do të kalojë edhe në leximin e dytë dhe do të jetë vështirë të kundërshtohet.

Labiot Berisha – që në fillim kur kam diskutuar kur është nxjerr ky Ligj në pah nga kryetari i Komunës që në fakt nuk falet për ata të cilët kanë punuar dhe nuk e kanë bërë publik këtë Ligj veç dy vite nga grupet e punës të ndryshme. Kam thënë që ne kot është nëse lëshohemi vetëm në aspektin deklarativ që ky Ligj është i padobishëm, që nuk duhet të jetë në Komunën e Rahovecit, e degradon integritimin e tyre etj. Kjo realisht u pa edhe në seancën e jashtëzakonshme që është mbajtur këtu në Rahovec, që ne përgjithësi, por mbi të gjitha bie përgjegjësia në Ekzekutivin sepse nuk u ofruan argumente të forta rreth monumenteve që janë në këtë fshat, tjetërsimi i atyre monumenteve e gjëra të tilla, që të bindin deputetët e Parlamentit të Kosovës që vërtet këtë Ligj nuk duhet të përkrahet as në leximin e parë së paku deri sa të bëhet një skanim i qartë i të gjitha atyre monumenteve që pretendohet që janë në këtë qytet. Ka qenë një mbështetje shumë e madhe e të gjitha subjekteve politike nga Kuvendi komunal, që Komuna të ketë fuqinë më të madhe në kuptimin e angazhimit që të parandalon këtë Ligj. Nëse ky Ligj përfundon i miratuar nga Kuvendi i Kosovës në të ardhmen bie një përgjegjësi goxha e madhe morale mbi të gjithë neve të cilët kemi qenë në këtë kohë të mandatuar që të bëjmë diçka më shumë në lidhje me këtë Ligj, sepse ne do të krijojmë argumente juridike që përmes këtij Ligji t’i certifikojmë ato monumente siç tha z.Shala për tjetërsimin e atyre monumenteve në kisha apo prej atyre ortodokse shqiptare që janë bërë në ortodokse serbe. Duhet të jetë një grup i atyre

ekspertëve të cilët ne i kemi brenda Komunës së Rahovecit, qoftë brenda institucioneve të Komunës, qoftë edhe jashtë dhe ekspert nga Prishtina që të merren dhe të bëhet një anamnezë e përgjithshme e këtyre monumenteve që ne të kemi argumente sa më të mëdha që të kundërshtojmë këtë Ligj me fakte e jo vetëm me deklarata.

Smajl Latifi – ky Projektligj dhe ai i Prizrenit janë kryekëput tema të pastra politike dhe janë pothuajse edhe kërkesa të bashkësisë ndërkombëtare prezentë në Kosovë, ndërkaq edhe po t'i numërosh dhe t'i dërgosh me mijëra fakte dhe argumente historike, politike dhe ato juridike është e pamundur, dmth. sipas atyre që e kanë sponsorizuar dhe draftuar këto projektligje, ata i trajtojnë si obligime ose si detyrime të cilat duhet me i kaluar. Ne si komunë e kemi bërë maksimumin ndërsa format tjera të kundërshtimit si që është me peticion apo me ndonjë mjet tjetër juridik është maksimumi që mundet të bëjë një Komunë. Suksesi ynë është që ne e kemi nxjerr në sipërfaqe këtë temë dhe është rezultati i jonë i përbashkët, është debatuar, po debatohet dhe ka mundësi të debatohet lidhur me dobishmërinë apo jo dobishmërinë e këtij Ligji apo rrezikshmërinë ose arsyeshmërinë e këtij ligji. Na kemi bërë këtë debat dhe komuna jonë prinë pse e ka publikuar këtë lajm sepse po të mos kishim reaguar as në Parlament të Kosovës nuk do të ishte debatuar fare. Ne kemi argumente të mjaftueshme, mirëpo këto nuk janë konsideruar si fakte dhe argumente të dobishme që ndikojnë në parandalimin e kalimit të këtij Ligji. Edhe ata që kanë votuar “për” e dinë fare mirë kush është Hoça e Madhe dhe rrezikun dhe pasojat që prodhon ky Projektligj, por edhe ata që kanë votuar kundër edhe ata e dinë. Ne si Komunë jemi sjell konform rrethanave dhe i kemi shfrytëzuar ato mundësi, ato mjete juridike të cilat i kemi në dispozicion.

Salih Hoti – tema për të cilën po bisedojmë për neve është shumë e rëndësishme dhe është shumë jetike ndërsa për ndërkombëtarët është e parëndësishme dhe është shumë e thjeshtë që duhet a mos me e debatua këtë çështje. E keqja është që se përfaqësuesit tonë që kanë marr në hartimin edhe të pakos së Ahtisarit, absolutisht nuk e kanë shqyrtuar materien që është ofruar në ato bisedime dhe symbyllur janë pajtuar që bëhet kështu. Në këtë rast nuk bëhet fjalë për fakte, a janë të rëndësishme apo të parëndësishme, për ata që kanë propozuar këtë Ligj faktet janë të parëndësishme. Jam i befasuar në një gjë se po bëhen 20 vite që bashkësia ndërkombëtare ka kohë, ka nerva, ka potencial financiar, ka vizion me u marr veç me kërkesat e serbeve në Ballkan dhe nuk e di edhe sa dekada u nevojiten për me i plotësuar kërkesat dhe dëshirat e tyre. Çka është më keq këtu thuhet që për neve pakoja e Ahtisarit është Bibël, thuhet që është e pa ndryshueshme e që sipas meje absolutisht nuk është ashtu dhe sa herë që serbet parashtrojnë kërkesë të reja kjo pako e then atë që është Bibël. Këtu thuhet që me u marr në mbrojtje, unë nuk e di prej kujt janë të kërcënuar ato monumente dhe mbrojtja e monumenteve të njëanshme vetëm të serbeve në këtë rast, është duke u bërë diskriminim i hapur që nuk bëhet në asnjë vend tjetër. Në njërën anë thonë zbatoni pakon e Ahtisarit, në anën tjetër para disa ditësh Piter Fejti del me propozimin që serbët në Kosovë të kenë njëfarë autonomie të ngjashme me Kataloninë. Qëllimisht janë kah hartohen këto ligje për të bërë pengesa të brendshme në zhvillim të Kosovës, për të mos mundur ecur përpara. Ne si Kuvend komunal duhet të kemi hapat konkrete, unë mbështes një peticion që është ndërmarr prej shoqatave të Komunës dhe kërkoj që Kuvendi i Komunës të mbështes seriozisht këtë peticion. Çështje tjetër, nëse ky Ligj do të aprovohet në mënyrë të dhunshme prej institucioneve “kuklla”, ne si Kuvend komunal duhet të marrim hapat e kundërshtimit konkret dhe nëse vazhdohet kështu me këtë politikë jam në gjendje si këshilltar komunal të dorëzoj mandatin sepse neve gjithmonë duhet të lëshojmë pe. Kjo është çështje politike dhe nuk është vetëm punë e kryetarit dhe e Ekzekutivit që të merren me këtë dhe më shumë na takon neve si Kuvend, ndërsa ne nuk pyetemi për asgjë dhe atëherë pse të rrimë këtu dhe të shpenzojmë buxhet së koti dhe të mos mbajë kurrfarë përgjegjësie për Projektligjin që bëhet atje dhe nëse na imponojnë me zor me thënë se nuk na kanë pyetur neve.

Rasim Fazliu – ne Grupi i këshilltarëve të PDK në këtë Kuvend jemi kundër këtij Projektligji dhe i bashkëngjitem të gjitha arsyetimeve që i dhanë kolegët më parë sepse ky Projektligj është i rrezikshëm dhe e rrezikon territorin e Komunës së Rahovecit. Kisha e ka territorin e vet dhe është shpallur zonë e mbrojtur, përndryshe pjesa kadastrale e Hoçës së Madhe nëse shkohet në atë mënyrë, atëherë është një humbje shumë e madhe për Komunën e Rahovecit dhe nuk duhet lejuar në asnjë mënyrë dhe duhet të paraqesim shqetësimin siç kemi paraqitur më herët dhe Kuvendi i Kosovës duhet t'i merr parasysht këto vërejtjet tona që i kemi dhënë. Edhe në diskutimet e mëparshme kam thënë se bashkë pakica

serbe por edhe të gjitha pakicat tjera është mirë që të integrohen në institucionet komunale dhe të kenë përfaqësuesit e vetë për të mbrojtur interesat e tyre e jo të ndahen në zonat e veçanta ngase kjo nuk është mirë as për ata e as për neve. Nuk është kjo çështje që i takon një grupi politik në Kuvendin e Kosovës dhe t'i mëveshët i tërë faji grupit politik, por ne e dimë mirë që partitë politike kanë pasur përfaqësuesit e vet dhe të gjithë ashtu të mirë apo të keq e kanë pranuar pakon e Ahtisarit, kështu që atëherë është dashur të ngulim këmbë të gjithë dhe të mos e pranojmë pakon e Ahtisarit. Nuk jam për atë që tani ti japim konotacione politike dhe t'i lihet faji dikujt sepse e dimë që askush nuk e donë pakon e Ahtisarit ngase është e keqe në disa çështje, mirëpo e kanë pranuar atëherë të gjithë përfaqësuesit dhe tani duhet ecur përpara sepse nuk kemi të shkojmë më tutje. Edhe një herë po them se ne jemi kundër këtij Projektligji dhe do të jemi gjithmonë vazhdimisht.

Fehmi Hoxha – është e qartë që edhe në seancën e kaluar të gjitha grupet parlamentare e kanë kundërshtuar këtë Projektligj, mirëpo unë mendoj se ne duhet të japim alternativë. Kryetari na informoi shkurtimisht rreth rrjedhës së aktiviteteve të tij për këtë Projektligj, mirëpo mendoj që ne duhet të punojmë pak më ndryshe, të formojmë një grup ndërpartiak si Kuvend i cili do të del me amandamentimin e neneve të caktuara ku ne kemi vërejtje në këtë Projektligj. Pas punës profesionale që do të bëhet ku do të kyçeshin më shumë juristë dhe më pas këtë propozim në emër të Kuvendit komunal t'i dorëzohet Komisionit parlamentar për këtë Projektligj. Ata do ta pranojnë dhe me siguri në seancat e radhës në Kuvend të Kosovës do ta prezantojnë si shqetësim dhe si propozim e amandamentimit të disa neneve në këtë Projektligj. Nëse ne e kundërshtojmë atëherë duhet të kemi alternativa se çka ofrojmë.

Feim Fetoshi –Ky Ligj nuk është i mirë dhe ne duhet t'i tregojmë hapur që ky Ligj më shumë se sa për shumicën shqiptare është i keq për vetë pakicën serbe sepse edhe pse në dukje duken si disa privilegje që do të fitojnë ata në raport me izolimin që e fitojnë, nuk ia vlen për asgjë për vetë serbet. Andaj që në fillim përkrahja që është bërë nga ky Kuvend komunal dhe nga të gjitha partitë politike nuk është kapitalizuar aq sa duhet. Pajtohem që ne duhet të amandamentojmë këtë Ligj. Ne jemi Kuvend komunal dhe thjeshtë po debatojmë dhe është mirë edhe të kundërshtojmë në forma të ndryshme, por në forma bindëse që ky ligj nëse jo të hudhet plotësisht së paku të amandamentohet në atë formë që të mos jetë aq kontraverz siç është në këtë formë të tanishme. Ndoshta një formë e një komisioni ndërpartiak siç tha kolegu më parë do të ishte me vlerë që ato amandamente të propozuara të precizohen, të evidentohen edhe pse është pak vonë sepse të kishim vepruar më herët kishte pasur efekt, që njerëz qoftë nga Ekzekutivi apo Kuvendi komunal të kontaktojnë edhe me qytetarët e Hoçës së Madhe, sepse ky Ligj vetëm institucioneve paralele i shkon për shtati dhe Qeverisë serbe, ndërsa absolutisht nuk është në të mirë të qytetarëve të Hoçës së Madhe. Po të kishim pasur në fillim gatishmërinë dhe të kishim biseduar me qytetarët të thjeshtë të këtij fshati besoj se do të kishim arritur ndonjë iniciativë nga vetë ata që në një farë mënyre ta kundërshtojnë dhe kundërshtimi nga vetë ata do të ishte një argument shumë i madh. Nëse juristët mendojnë se nuk është vonë besoj se ndoshta së paku amandamenti i këtij Ligji do të mund të bëhet në një farë mënyre apo të bëjmë presion në kuvendarët e Parlamentit të Kosovës që edhe nëse tek e fundit mendojnë që duhet të aprovohet së paku të aprovohet i amandamentuar në atë formë që nuk do të jetë kontraverz dhe në kundërshtim me ligjet në fuqi.

Xhihad Vuçitërna – kjo është hera e tretë që e kundërshtoj këtë Projektligj dhe aprovimin e tij nga Kuvendi i Kosovës dhe duhet të jemi i qartë se ne si PD jemi kundër Ligjit e jo kundër disa amendamenteve apo modaliteteve që ka ai ligj, por jemi kundër Ligjit në përgjithësi, jemi kundër çdo lloj Ligji që e veçon ose diskriminon një komunitet, një zonë kadastrale, një bashkësi fetare apo një grupacion tjetër. Për këtë nuk jam i pajtimt që të arrihet njëfarë kompromisi në mes të kërkesave tona dhe ligjit në fjalë dhe të bëhen disa ndryshime ku të dyja palët kishin me qenë në pajtim. Mendoj se është dyfytërsi dhe hipokrizi e Parlamentit të Kosovës i cili mu atë dytë kur është aprovuar ky Ligj, ka trumbetuar gjithë kohën që Kosova është shtet laik, ndërsa u aprovua një Ligj i cili i jep të drejtë Kishës ortodokse serbe që të administroj me një territor të Kosovës, me një zonë kadastrale të formoj Komunë. Prandaj, ne asnjëherë nuk do të pranojmë këtë Ligj as me ndryshme, amendamente apo modalitete tjera, por ne e kundërshtojmë në përgjithësi. Në anën tjetër po dëgjoj që ne si Kuvend komunal nuk kemi fuqi dhe mundësi që të stopojmë aprovimin e këtij Ligji që do të thotë se i kemi duart e lidhura atëherë çka na mbetet neve që të bëjmë. Kisha lutur që ne të fillojmë me propozimin e

zgjidhjeve konkrete dhe nëse nuk ka zgjidhje konkrete që të parandalojmë këtë ligj atëherë pajtohem me kolegun Salih që të gjithë ne të dorëzojmë mandatin pasi që jemi në pamundësi për të zbatuar vullnetin e popullit.

Sinan Ejupi – edhe ne si grup politik kemi shprehur qartë opinionet tona për këtë Projektligj kriminal, mirëpo si duket pas të gjitha atyre orvatjeve edhe të Qeverisë komunale, të deputeteve, mediave, shihet qartë se ky Projektligj me çdo kusht do të kalojë, do të gjinden forma se si do të kalojë, prandaj ne si grup politik nuk dyshojmë se ky Ligj do të kalojë në leximin e dytë. E keqja më e madhe e këtij Projektligji përpos tjerash do të ndikojë kryekëput në jetën e thjeshtë të qytetarëve të Komunës së Rahovecit por edhe në zhvillimin ekonomik të Komunës, është te përmasa territoriale të cilat janë të Hoçës së Madhe. Një prej propozimeve që mund të japim ne si Kuvend është të ndryshohet territori të cilin e ka kufizuar ky Projektligj. Nëse Projektligji donë t'i mbrojë monumente fetare, e ne e dimë se si mbrohen ato sepse mbrohet objekti dhe një pjesë e territorit ku është i vendosur objekti, por ky Ligj nuk e ka për qëllim mbrojtjen e monumenteve fetare por ka për qëllim copëtimin e Komunës së Rahovecit respektivisht krijimin e zonave të veçanta për serbet, sikurse i kanë zonat të tjera. Njëra prej pikave që mund të ndryshohet në këtë Projektligj, të zvogëlohet territori i cili kishte me qenë rreth 200 m prej fshatit H.Madhe që është momental prej shtëpive të fundit, le të mbrohet ai territor dhe kishte me qenë e keqja më e vogël çka kishte me i ndodhë Komunës në të ardhmen. Përndryshe jam dakord me Salihun dhe i ftoj të gjithë deputetët e KK-së për dorëzimin e mandatave si masë radikale dhe atë pa shtyrje të afatit dhe atëherë Qeveria le të merret me popullin.

Smajl Latifi – edhe një herë po e përsërisë se i kemi artikuluar qartë në aspektin politik, juridik, ekonomik, gjeografik dhe historik, i kemi prezantuar dhe përfaqësuar në mënyrë dinjitoze interesat e Komunës tonë para vendorëve – Qeverisë së Kosovës edhe para Parlamentit të Kosovës si dhe Bashkësisë ndërkombëtare përkatësisht të faktorëve të involvuar në këtë çështje. Kam vizituar këtë fshati dhe kam pasur takime të drejtpërdrejta me banorë, kam sqaruar për aq sa kam mundur se sa i rrezikshëm është ky Ligj për ata dhe këtë fakt e kemi prezantuar në takime me përfaqësues të tyre, në takime me përfaqësues të Qeverisë së Kosovës dhe në takime me anëtarë të Kuvendit të Kosovës. Unë ndryshe e kuptoj pakon e Ahtisarit, mirëpo po supozojmë kryesuesi e kupton ndryshe. Ndryshe ne e kuptojmë partneritetin me Bashkësinë ndërkombëtare, dikush tjetër e kupton ndryshe. Kjo është situata reale në Kosovë. Ne jemi të vetëdijshëm dhe të informuar që pakon e Ahtisarit e kanë pranuar në vitin 2007, mirëpo, diçka që ke pranuar para 4 vitesh nuk do të thotë tani të pranosh në vazhdimësi diçka që është e dëmshme ose mund të komplikoj jetën dhe funksionimin e institucioneve të Republikës të Kosovës por edhe jetën e qytetarëve të sajë. Ne nuk mund të organizojmë protesta tani si institucione komunale, mirëpo në qoftë se Shoqëria civile ose qytetarët e Komunës organizojnë protesta, unë i mbështes plotësisht, sepse kanë arsye që të organizojnë dhe mbajnë protesta apo të aplikohen format e kundërshtimit të përdorimit të mjeteve juridike dhe mjeteve praktike paqësore për të kundërshtuar një Projektligj i cili është i dëmshëm për Komunën tonë. Partitë politike e kanë thënë fjalën e vet në Komunën tonë, mirëpo qendrat e partive politike që janë në Prishtinë nuk e kanë kuptuar drejtë, nuk kanë dashur ta kuptojnë drejtë ose nuk kanë mundur ta artikulojnë në mënyrë të qartë interesin e Komunës tonë. Ne kemi bërë aq sa kemi mundur dhe mendoj se kemi bërë maksimumin për parandalimin e këtij Ligji.

Esad Haxhijaha – rreth kësaj çështje kam thënë mendimin tim që në bisedat e para dhe sot kaloi një orë e gjysmë duke biseduar për të njëjta gjëra. Në disa diskutime kishte disa mos informime të duhura. Për ruajtjen e monumenteve historike, kulturore, fetare e të tjera që kanë të bëjnë me interesin e përgjithshëm të qytetarëve në një vend dhe në Kosovë ekziston Ligji dhe është aprovuar Ligji mbi ruajtjen e këtyre monumenteve për tërë Republikën e Kosovës ku janë edhe monumentet edhe nga Hoça e Madhe. Por ky orientim për një draft të ri të Ligjit në Hoçë të Madhe, në Prizren dhe ku ka nevojë, ministrinë tona kanë marrë si të nevojshëm meqë në institucione ku bisedohet për këto nuk ka përfaqësues të këtyre vendeve. Çdo bisedë e cila bëhet për interesa të çfarëdo vendi pa prezencën e përfaqësuesit të tij nuk mund të jetë e frytshme. Ne kemi përfaqësues të Fortesës të cilët ndalojnë ndërtimin e fabrikës. Në Xërxe disa rahovecian kanë blerë troje pranë rrugës ndërsa qytetarët e Xërxës tonë se nuk ka rahovecian i cili mund të shkel këtu. A ka arsye kjo, a është me vend dhe në një farë mënyre ndoshta po, sepse është dashur të pyeten fqinjët, sepse kështu parashihet edhe sipas Kanunit dhe sheriatit ngase së pari duhet të pyeten se a pranojnë si fqinj. Askush prej neve nuk është interesuar

që t'i dëmtoj monumentet historike e aq më pak me i rrezikuar. Është kjo e drejtë e qytetarëve të Hoçës së Madhe me i ruajt dhe që për këtë askush nuk ka kundër, por nëse me këtë draft Ligj pengohet zona industriale të cilën ne e kemi aprovuar në vitin 2003 ku kanë filluar të ndërtohen objekte atëherë kjo duhet të verifikohet. Së pari të shihet deri ku shtrihet zona kadastrale e Hoçës së Madhe dhe nëse preken edhe këto territoret të cilat ne i kemi shpallur si zonë industriale kjo kishte me qenë arsye dhe logjikë që kjo zonë të mos hyjë në zonën e BL të H.Madhe. Qytetarët e Hoçës së Madhe me këtë fitojnë të drejtë që të interesohen rreth fshatit të tyre, rreth infrastrukturës së fshatit pa institucione të Komunës së Rahovecit, për ndërtimin e objekteve të mos jenë më të larta, më të ulëta e më të gjera që ndotin ambientin, kjo është e drejtë e tyre dhe nuk mund të mohoj askush. Nga kjo ka kaluar Ligji dhe jam i bindur se do të kalojë sepse kjo nuk është as dëshirë e Qeverisë tonë si dhe mundësia që ata ndërrojnë diç këtu, mund të ndërrojnë këtë që është e interesit ekonomik e qytetarëve të Komunës së Rahovecit, por jo edhe ajo që flet për interesat e qytetarëve të Hoçës së Madhe. Kaloi programi i Ahtisarit ndërsa ne kemi marr vesh pas 2 vite, kanë kaluar 6 pika në atë projekt që po ashtu qytetarët e Rahovecit nuk janë pajtuar dhe jemi informuar sërish pas 2 vite. Edhe shumë çështje bisedohet në nivele për të cilat ne nuk dimë, por ata që bisedojnë janë me siguri më kompetent, janë më të njoftuar dhe dinë më shumë se ne.

Ilirjana Gashi – të mos flasësh për këtë çështje të ndjeshme do të na bije si hije e zezë nesër për shkak të gjërave që do të ndodhin sepse nuk do të jetë një gjë e hijshme për Komunën e Rahovecit, por një gjë fatkeqe që po i ndodh. Kam frikën se serbet e Rahovecit në lagjen e epërme edhe ata do të kërkojnë të njëjtën gjë. Pyetje për kryetarin: atë ditë u fol për fakte dhe gjithë po pajtohem që ky Projektligj është kryekëput politik dhe nuk ka nevojë për dorëheqje, por nëse duhet dikush të jep dorëheqje atëherë do të ishin ata të Parlamentit të Kosovës, sepse ata janë ata të cilët i miratojnë këto ligje, e jo që vjen si rezultat nga ne. Faktet që i përmendi z.Nahit Hasani, a kanë mundur të vërtetohen ato kisha sepse është obligimi yni që të vërtetojmë ato.

Smajl Latifi – ne faktet i disponojmë e mos të flasim për historianë që e njohin këtë lëmi, por edhe neve që nuk jemi fare historian banorë të kësaj komune, duhet me qenë tepër i përfshirë secili prej nesh që të mos dimë për nomin e madh që ka lënë Hoça e Madhe edhe përtej Komunës së Rahovecit nga viti 1905 e deri në vitin 1999.

Avdullah Kryeziu – mendoj që KK së Rahovecit ka diskutuar mjaft për këtë Projektligj i cili është diskriminues për banorët dhe qytetarët e Komunës së Rahovecit e jo vetëm për komunitetin serb. Kuvendi ka dalë me një deklaratë shumë të fuqishme e cila i është dorëzuar deputetëve të Parlamentit të Kosovës gjegjësisht Komisionit parlamentar dhe nuk di se çka tjetër duhet të bëjmë ne këshilltarë përpos asaj deklarate që është shumë e fuqishme. Kryetari tha se është vërtet për të keq që ne jemi njoftuar shumë vonë si këshilltar të Kuvendit komunal. Ne jemi këshilltar të KK-së prej vitit 2009 e këtej dhe për këtë çështje nuk kemi pasur kurrfarë informacione e çka është më e keqja disa njerëz që kanë marr pjesë në Komision e të cilët sot paguhën prej Kuvendit komunal, asnjëherë nuk e kanë ngritë zërin për këtë Ligj diskriminues. Ne e dimë të gjithë se shpallja e pavarësisë së Kosovës është bërë në bazë të pakos së Ahtisarit, mirëpo megjithatë nuk e kemi ditur që po punohet në Projektligjin për Hoçën e Madhe. Nuk mund t'i lëmë fajin këtij Kuvendi që asnjëherë nuk është njoftuar për këtë çështje, që ka pasur komisione që kanë punuar, që paskan shkuar deri në Selanik dhe kanë punuar në këtë drejtim e ne jemi njoftuar para 4 muaj. Plotësisht pajtohem me diskutimet e mëhershme dhe ne duhet të punojmë në këtë drejtim, përpos deklaratës që e kemi shumë të fuqishme dhe të cilën nuk bënë të ndërrojmë, duhet të punohet në propozim që të ndryshohen nenet diskriminuese që janë në Projektligjin për Hoçën e Madhe. Këtë duhet të bëjë një komision i cili i njeh ligjet qoftë prej Kuvendit apo prej Qeverisë dhe të punohet në këtë drejtim që mos t'i lihet këtij Ligji të jetë ashtu siç është, por të ndryshohet, e çka duhet të ndryshohet, ata ekspertë të cilët do të punojnë në këtë Komision do ta thonë fjalën e vet.

Kryesuesi – kjo është seancë e katërt që po e diskutojmë këtë Projektligj ne si Kuvendi i Komunës, por edhe kryetari së bashku me Ekzekutivin është angazhuar mjaft në mënyrë më të mundshme ligjore që të parandalohet ky Projektligj. Konsideroj se e metë e këtij Projektligji është zona kadastrale që është një zonë mjaftë e madhe që përfshin territorin e Komunës së Rahovecit. Në lidhje me këtë çështje ne absolut nuk jemi kundër objekteve kulturore dhe fetare të këtij fshati edhe pse konsideroj që ato objekte së pari nuk dihen se nga kush janë ngritë dhe nuk dihet se kujt i përkasin, por pa marr

parasysht ato objekte edhe në këtë gjendje çfarë janë, asnjëherë nuk kanë qenë të rrezikuara, por nëse vërtetë është kërkesë e qytetarëve të fshatit H.Madhe që këto objekte duhet të ruhen atëherë ne pajtohemi me atë, le të ruhen objektet e nëse ka nevojë ne do të angazhohim edhe policë për të ruajtur ato objekte. Mirëpo, edhe nëse vendosim që të ruajmë ato objekte ne prapë duhet të kemi kujdes se çfarë aktivitete po zhvillohen nëpër ato objekte që ky komunitet i quan objekte shpirtërore e që nuk kanë të bëjnë me atë çështje fare duke ditur gjendjen e mëhershme duke filluar prej viteve 90-ta, pastaj edhe gjatë luftës ku pikërisht këto objekte janë shfrytëzuar për diskriminimin e popullatës shqiptare në të cilat janë zhvilluar mjaft debate e ku gjatë luftës janë mbajtur edhe armë, vetëm e vetëm për të diskriminuar popullatën shqiptare. Shumë politikan edhe gjatë viteve 90-ta kanë ardhur prej Serbisë dhe pikërisht aty e kanë shprehur mllëfin e tyre ndaj popullatës tonë. Por, pa marrë parasysht ato, ne konsiderojmë që çdo qytetar i Komunës së Rahovecit, madje edhe çdo qytetarë në Kosovë ka të drejtë t'i besoj një feje e që ne askujt nuk ia mohojmë atë ashtu që nuk kemi dëshirë që as neve të na mohon dikush tjetër, bile ne këtë drejtim kemi qenë tolerantë ne si shumicë shqiptare në Kosovë dhe asnjëherë nuk kemi pasur konflikte fetare dhe kjo për neve nuk mund të jetë një brengë e madhe. Mirëpo, rreziku më i madh është nga zona industriale e cila neve në të ardhmen do të na pengojë për zhvillimin ekonomik të Komunës së Rahovecit. Prandaj propozoj që ne si Kuvend i Komunës së bashku me kryetarin duhet të nxjerrim një Konkluzë të përbashkët që kërkesën tonë të hartojmë në mënyrë më të mirë të mundshme dhe nëse ka nevojë të thërrasim edhe ndonjë avokat dhe t'i drejtohem kryetarit të Parlamentit të Kosovës, Kryesisë të Parlamentit dhe të kërkojmë prej tyre që të përgjigjen me shkrim se çka mendojnë ata me kërkesën tonë. Nëse Kuvendi pajtohet që ne në mbledhjen e KPF e cila do të mbahet pasnesër që të nxjerrim një konkluzë të përbashkët me kërkesa tona si KK dhe t'i dërgojmë institucioneve më të larta.

Salih Hoti – nëse ne bëjmë debat rreth amandamentimit të Ligjit atëherë do të jemi bashkëpunues të hartimit që ne nuk guxojmë të jemi në këtë rast dhe askush prej nesh nuk ka kërkuar, por e jona është që të kundërshtojmë me çdo çmim dhe çdo kusht.

Nahit Elshani – ne këtu mund të flasim sa të duam dhe të japim mendime të ndryshme, por nuk është zgjidhje as me dorëheqje të neve këtu, se vijnë të tjerët të cilët do ta zbatojnë prandaj është propozimi që të propozohet një Komision prej partive politike. Duhet të jemi realist se pakon e Ahtisarit e kanë pranuar partitë tona dhe deshëm apo jo ligjet që dalin nga pakoja e Ahtisarit kalojnë dhe ato janë të implementueshme pastaj sepse nuk na pyet kush neve. Unë jam i vetëdijshëm që me ato ndryshime që kërkoja unë, nuk e pranon as Piter Fejti e as ndërkombëtarët por e jona është me dhënë alternativë, nëse i hiqen ato zona të mbrojtura dhe të jetë vetëm zonat ku janë objektet me rëndësi kulturore, historike dhe fetare, Komiteti të emërohet, por jo të zgjidhet me votë të drejtpërdrejtë, është që kisha të mos jetë pjesë e këtij Komiteti si institucion fetar, atëherë thjeshtë ky Ligj bëhet i pavlerë.

Kryesuesi – në takim me kryetarët e grupeve parlamentare erdhëm në përfundim që Kuvendi i Komunës së Rahovecit mbetet prapa deklaratës së mëhershme të aprovuar nga ky Kuvend më datë 04.07.2011 sepse jemi në mospajtim me aprovimin e këtij Ligji për Hoçën e Madhe.

2. Aprovimi i procesverbaleve nga mbledhje e 7.06. dhe 4.07.2011.

Nahit Elshani – në procesverbalin e datës 4 korrik në fq.3 është bërë gabim teknik aty ku thuhet: nuk është në përputhje me LVL ndërsa duhet të jetë: është në kundërshtim me LVL. Në fq.14 ku është: nëse arrin të realizoj kredinë ne dol t'i falim këtë parcelë. Duhet të jetë: propozoj që edhe t'i falet kjo parcelë.

Avdullah Kryeziu – në procesverbalin e datës 4.07. në fq.12 është bërë gabim ku thotë: ky regjistrim nuk ekziston fare dhe është rrezik që të humben, duhet të jetë: të humbet prona dhe ky problem të zgjidhet nga Komuna në të ardhmen. Në fq.15 te diskutimi im ku thuhet: çmimi i kësaj sipërfaqe të cilën ja kemi ndarë në vitin 2006, çmimi real është 100.000 € ndërsa në Zatriq mund të blesh sipërfaqen 50.000 e duhet të jetë 50 €. Në procesverbalin e datës 07.06, në fq. 5 ku shkruan: unë nuk kam qenë përfaqësues i Qeverisë duhet të jetë: unë kam qenë përfaqësues i Qeverisë.

Lumturije Hoti – në procesverbalin e datës 07.06. kam thënë që të dalim me një deklaratë dhe t'i dërgojmë Kuvendit të Kosovës e jo AKK-së, prandaj të bëhet ky përmirësim.

Me këto plotësime janë aprovuar procesverbalet nga data 07.06. dhe 04.07.2011.

3. Shqyrtimi i Raportit të Kryetarit të Komunës për situatën ekonomike financiare të Komunës dhe zbatimin e planeve investuese për periudhën gjashtëmujore janar-qershor 2011.

Smajl Latifi – raporti është përgatitur më herët dhe i kemi dërguar KPF ku edhe është trajtuar. Raporti përmban shifra dhe informacione të bollshme, paraqet angazhimin 6-mujor, vështirësitë, të arriturat, pengesat. Ne i mirëpresim vërejtjet, sugjerimet, kritikën, natyrisht është një raport bukur i gjerë që duhet të trajtohet me seriozitet dhe ne jemi të gatshëm që sqarime e nevojshme aty ku ka paqartësi.

Rexhep Oruçi –kam disa vërejtje që mund të jenë edhe gabime teknike administrative sepse që në fillim të Zyra e kryetarit thotë pamundësia e livrimit të Buxhetit të konsoliduar, pastaj mungesa e planifikimit adekuat buxhetor, konsolidimi i institucioneve të Komunës pas situatës të jashtëzakonshme. Komuna e Rahovecit situatën e jashtëzakonshme nuk e ka pasur asnjëherë, me dorëheqjen e kryetarit të Komunës nuk krijohet e gjendja e jashtëzakonshme, kur dihet se në çfarë rrethana dhe kur shpallet gjendja e jashtëzakonshme. Me shkuarjen e kryetarit të Komunës ka funksionuar pozicioni i nënkryetarit të Komunës si dhe stafi i Ekzekutivit ka qenë komplet, prandaj nuk mund të trajtojmë që kemi pasur gjendje të jashtëzakonshme. Tek Drejtoria e arsimit janë paraparë mjete buxhetore për investime në të ardhmen rreth 624.000 € ndërsa nuk ceket se për cilën shkollë kështu që nuk e kam të qartë se ku do të investohet kjo shumë. Te Drejtoria për Shërbime Publike Komunale, investimet në Rahovec, në rrugën “V. Frashëri”, vazhdimi i investimeve në vazhdimin e kanalizimit të asaj pjese, nuk dihet sa është investuar dhe po ceket se kjo është vazhdimësi e punës të ish Ekzekutivit nga viti 2009. Investimet për këtë lagje janë bërë në vitin 2010 ndërsa ka mbetur një pjesë e papërfunduar për shkakun e pazgjidhura pronësore juridike, mirëpo nuk shihet se sa është investuar. Në fund janë paraparë disa pozicione për investime proporcionalisht në secilën pjesë të Komunës në çdo fshat dhe në qytet duhet të investohet ose bile të fillohet me disa projekte kapitale. Është muaji i shtatë ndërsa unë nuk vëreja që në Rahovec është bërë ndonjë hap përveç kanalizimit që është përmendur në vlerë prej 70.000 € ndërsa nuk po e vërej ndonjë aktivitet tjetër sepse këto janë edhe vërejtjet e qytetarëve. Si shembull po e marri se janë paraparë me buxhet për këtë vit diku rreth 70.000 € për rregullimin e shtratit të lumit “Duhlllo”, jemi në muajin e nëntë dhe dyshoj që mund të bëhet diçka në këtë vit. Janë paraparë mjetet për përfundimin e furnizimit me ujë të pijes për Rahovec në vlerë prej 50.000 €, ndoshta ka pasur projekte të gatshme ish Qeveria, por nuk është ndërmarr në këtë drejtim asgjë. Sigurisht se në mungesë të investimeve ka edhe mjedise tjera, janë bërë disa hapa pozitive, por të gjitha janë këto projekte që janë paraparë nga Qeveria e kaluar. Të mos flasim edhe për tejkalime që në fazën e parë të investimeve si që janë zotuar mjetet për Opterushë në vlerë prej 80.000 € ndërsa tenderuesi i parë e ka marrë me 89.000 € dhe nuk e di se a është e mundur që në fillim të rriten këto mjete apo duhet në fazën tjetër si punë shtesë.

Burim Krasniqi – kam disa vërejtje te Drejtoria e arsimit sepse nuk është cekur në raport çështja e nxënësve të shkollave të mesme që kanë pasur shumë mungesa pasi që i është lënë në kompetencë kryetarit të Komunës. Te Drejtoria e Shërbimeve Publike, te grafikoni fq.27 – realizimi i përqindjeve sipas muajve a është përqindje e planifikuar mujore prej 20% apo planifikimi vjetor me këtë përqindje sepse nëse është realizmi prej 20% është realizimi shumë i vogël. Sektori i emergjencave në këtë Drejtori thotë se është bërë inspektimi i pikave të karburanteve derivateve dhe të gazit është një punë e mirë, por askund nuk ceket që në aspektin e emergjencës së sigurisë që gjendja e tyre garanton sigurinë apo jo për të pasur një pasqyrë se ku jemi sepse është konflikti i drejtpërdrejt i qytetarëve. Te Drejtoria për bujqësi e di që nuk është kompetencë e juaj pasi që buxheti ka qenë i paraparë në vitin e kaluar, mirëpo ka disa pozicione të cilat kanë mungesë financiare dhe duhet kushtuar rëndësi bujqësi ngase jemi vend bujqësor. Te rrugët fushore në fund të realizimit ceket që bëhen para masat e që mendoj se është e vonuar sepse këto rrugë është dashtë të rregullohen në pranverë sepse nëse mirëmbajtja bëhet në vjeshtë për shkak të reshjeve nuk ka kurrfarë efekti. Drejtoria për bujqësi duhet të ketë një pasqyrë se sa sipërfaqe ka me vreshta dhe kultura tjera bujqësore që të dimë edhe ne si kuvendarë në të ardhmen, në qoftë se ballafaqohem me një debat të caktuar me ditë se ku qëndron Komuna e Rahovecit në aspektin e bujqësisë. Një përgjigje se kush i lëshon lejet e punës Drejtoria për ekonomi apo Drejtoria për punët inspektuese sepse ka s’përputhje në tabelarin ngase Drejtoria për ekonomik nuk ceke të hyra për leje ndërtimi ndërsa te një tabelar në fund të fq. 75 ceken të hyra për

leje ndërtimi 3.213 €. Te tabelari i Inspektoratit thuhet që janë disa të hyra nga dënimet, gjobot e inspektoratit mirëpo në fund të tabelarit te pozicioni 13 – gjoba nga Inspektorati në 2011 janë zero. Te Raporti i Inspektoratit thuhet 6.710 € ndërsa në tabelar 6.075 € që është një diferencë që nuk përputhet. Në projektbuxhetin e vitit 2011 është paraparë një trafo në Xërxe boll pak por a planifikohet të realizohet.

Smajl Latifi – ne mund të cilësojmë si situatë e jashtëzakonshme po në fakt është situatë e jashtëzakonshme për faktin që mungon i pari i Komunës së Rahovecit. Mungesa e levritimit të buxhetit të konsoliduar si fjali ndoshta mund të mos jetë shumë e qartë, por siç e dimë ne të gjithë në fund të marsit është miratuar Buxheti i konsoliduar i Republikës së Kosovës. Ndërkaq Buxheti i Komunës së Rahovecit është miratuar në tetor të vitit 2010 dhe ne kemi pasur vështirësi në kuptimin e qasjes në fondet Buxhetit të konsoliduar të Republikës së Kosovës, për shkak të situatës në të cilën ka kaluar Republika e Kosovës me zgjedhjet tjera. **Është e vërtetë që** ne jemi përballuar me situata të rënda edhe për mungesë të qasjes për të shfrytëzuar maksimalisht fondet që vijnë nga Qeveria e Kosovës sepse ne vetëm 1/12 e buxhetit kemi pasur të drejtë ta përdorim kur Buxheti i Republikës së Kosovës ka qenë i pa miratuar. Hartimi i buxhetit nga ana e qeverisë së kaluar është debatuar në KPF, në debatin publik dhe në fund ka marr vullën e Kuvendit dhe ne e kemi prezantuar këtë fakt, mirëpo ka ndoshta ngecje në kuptimin e planifikimit ose nuk ka një planifikim adekuat dhe për faktin që po shohë janë planifikuar shpronësimet në sahat Kullë. Ne kemi bërë përpjekje, kemi zhvilluar konsultime edhe me njerëz të ndryshëm të Komunës që është tepër e vështirë të realizohet Projekti i shpronësimeve afër sahat kullës. Ne kemi pasur një projekt të planifikuar për qytet - shpronësimi i ndërmarrjes “Ambienti”, po ashtu është një projekt i cili është tepër vështirë që brenda një afati të shkurtër të realizohet. Kemi pasur edhe një projekt tjetër për pastrimin dhe rregullimin e shtratit të lumit “Duhlllo”, janë ndarë mjetet dhe e kemi të qartë se ju vetë e keni vulos se sa mjete janë ndarë për të gjitha këto projekte, mirëpo ne nuk e kemi parë mundësinë e realizimit të këtij Projekti për këtë vit, por nuk do të thotë se nuk do të ndërhyjmë pikërisht në këtë vit në pastrimin e këtij lumi. Për sa i përket përforsimit të infrastrukturës për më shumë ujë të pijshëm në qytet, ne e kemi shpallur tenderin, projekti nuk ka qenë në Komunën tonë – në sirtarët e Qeverisë komunale e as të Qeverisë së kaluar, projekti kryesor është hartuar, kemi pasur një takim edhe me “Radoniqin” dhe me Ministrinë e zhvillimit ekonomik dhe ka mundësi që tash veç është mbyllur tenderi dhe fillon procesi i vlerësimit. Kuvendi i Komunës i ka ndarë 40.000 € për atë projekt dhe shpresojmë që edhe pjesën tjetër të mjeteve do të kemi si mbështetje nga Ministria e zhvillimit ekonomik. Sa i përket projektit të kanalizimit në rrugën “V.Frashëri” asnjë cent nuk kemi harxhuar për funksionalizimin e projektit, vetëm kemi kërkuar nga operatori të ndërmerr disa veprime që ta bëjë funksional dhe kemi zhvilluar një mori konsultime dhe negociata me ata që kanë pasur probleme pronësore juridike dhe që kanë penguar dhe mirë që kemi arritur një marrëveshje ato 30-40 m kanal tani janë hapur dhe projekti i kanalizimit mund të llogaritet që është i përfunduar ose është funksional. Lëvizjet në qytet në kuptimin e realizimit të projekteve konsideroj që shumë shpejtë mund të kemi edhe me këto kode që i ka miratuar Kuvendi i Komunës, do të kemi kubëzimin e rrugës “V.Frashëri” dhe do të bëjmë përpjekje po ashtu me ata që pengojnë ose që eventualisht mund të pengojnë hapjen e rrugës, ne do të bëjmë përpjekje njëkohësisht me hap rrugën dhe të sigurojmë qasjen në rrugën magjistrale. Ne po përpiqemi që këtë ta marrim pëlqimin nëse duhet nga Kuvendi i komunës, nga Ministria e financave për të ndërtuar murin në rrugën “Mizahir Isma”. Ne do të përpiqemi që sivjet po ashtu në qytet të shfrytëzojmë maksimalisht nëse na jepet pëlqimi të rregullojmë kanalizimin e ujërave atmosferik te bodrumi i vjetër që është një projekt i madh dhe me rëndësi të jashtëzakonshme. Nuk ka pasur rishqyrtim të buxhetit dhe atë në asnjë komunë e as në Qeverinë e Kosovës dhe kjo na ka vështirësuar për hapjen e kodeve për projekte të reja. Projekti i trafove Sapniq dhe Xërxe ne i kemi bërë para masat dhe do të ketë veprime konkrete shumë shpejt. Ne po përpiqemi që në tërë komunën të Rahovecit të na përgjigjet pozitivisht me asetet, mekanizëm, pajisje KEK-u për të stabilizuar gjendjen energjetike në kuptim të infrastrukturës me rrjete, trafo etj. Në lidhje me taksat nuk ka kod për taksat që mblidhen të identifikohen si taksa të një drejtorie të caktuar. Raporti se sa gjoba në trafik kemi dhe sa mjete financiare ka fituar komuna e jonë në gjashtëmujor, mund të kemi marr për korrik ose gusht prandaj edhe figuron zero. Në Zyrën e kryetarit mungon edhe një pjesë e raportit që ka të bëjë me Avokatin publik të komunës.

Fehmi Hoxha – në faqen e parë të Drejtorisë KSR përmendet më 4 mars janë vendosur flamuj kombëtar në varrezat dh përmendoret e dëshmorëve e që kjo drejtori nuk ka për obligim të vendos flamuj sepse ajo është servis i Komisionit komunal për manifestime, shënime dhe përkujtime dhe në Komunë duhet të ketë Komisioni i cili do të merret me këto ngjarje të rëndësishme kombëtare e jo Drejtoria për kulturë. Më tutje përmendet për sport që për mua është absurde të evidentohen disa ngjarje shumë të vogla ku thuhet me ndihmën e kryetarit dhe drejtorit janë bërë kontrollet mjekësore etj. dhe në fund të raportit ceken shpenzimet të cilat janë bërë nga buxheti i KK-së dhe nga donatorë. Është cekë se në muajin maj është bërë edhe shënimi i ditës së Qendrës kulturore, nuk është shënim por është kremtimi i ditës së Qendrës kulturore. Duhet të organizohen aktivitetet e shumëllojshme për ditën e Qendrës kulturore. Nuk është akademi përkujtimore që të shënohet. Janë mbajtur shumë ngjarje me rëndësi kulturore për nder të ditës së Qendrës kulturore “Mensur Zyberaj” në Rahovec, ka pasur edhe muaji i kulturës dhe java e kulturës, jo shënim, ju e keni shënuar, keq. Në Bibliotekën e qytetit janë regjistruar vetëm 3 lexues të rinj, në Bibliotekën e Krushës janë regjistruar vetëm 3 lexues, kjo është katastrofë kulturore. Unë besoj fuqishëm që kjo është gabim, nëse janë regjistruar vetëm 6 lexues në Komunë të Rahovecit është katastrofë në bibliotekë dhe besoj që është gabim. Rreth buxhetit, shpenzimet e bëra nga ana e Drejtorisë për Kulturë ceket se në këtë muaj janë bërë 240 € kurorat e blera. Nuk blihen kurora prej buxhetit e Drejtorisë për KSR e as flamuj për zyrën e kryetarit prej 15 €, kultura i ka aktivitetet tjera. Ndarja buxhetore: Festivali folklorik “Anadriina Jehon” 2011 janë ndarë 3.800 €, KF “Rahoveci” i cili garon në Ligën e I-rë i janë ndarë vetëm 1.500 € që janë shumë pak, Klubit të peshkatarëve 300 € ndërsa ky klub fare nuk ekziston për është Shoqatë, SHKA “Anadriina Jehon” 450 € për pjesëmarrje në Festivalin “Sofra Dardane” shumë në rregull bile është dashur më shumë, KF “18 Korriku” 900 € besoj që është pak. Në çdo aktivitet kulturor të shënuar këtu është Shoqata “Art studio” e cila ka qenë e involvuar në mënyrë direkt ose indirekte ndërsa asnjë centë nuk i keni dhënë e as SHKA “Rahoveci”. Për sektorin e Rinisë nuk është përfshirë fare dhe çka është shqetësuese rreth sfidave, një ndër sfidat tjera për ne ka qenë ajo në investimet kapitale të parapara për 6-mujorin e parë dhe atë në shpronësimin e pronave përreth objektit të sahat kullës që ndodhet në Rahovec. Në mungesë të mjeteve financiare të parapara nuk ka mundur të ndodh ky shpronësim. Kush po thotë që ka mungesë të mjeteve financiare sepse Kuvendi komunal ka ndarë mjete financiare dhe është dashtë të bëhet ky shpronësim. Sfidat tjetër zhvendosja e Ndërmarrjes Publike “Ambienti” në Rahovec, edhe për këtë ekzistojnë mjetet. Sfidat e radhës thuhet kështu: Në investimin kapital me buxhet të Drejtorisë është ajo në renovimin e zhveshtores pranë stadiumit të qytetit. Më herët keni thënë që ajo duhet të rrenohet, mjetet janë ndarë dhe planifikimi ka qenë që zhveshtorja të bëhet përbrenda e jo në kuadër të kompleksit sportiv i cili është në ndërtim e sipër. Po i përmendi disa nga ngjarjet shumë me rëndësi kulturore dhe sportive të cilat nuk funksionojnë e të cilat kanë funksionuar shumë mirë. Në kulturë: Festivali i dramës dhe i humorit, ky festival ka ekzistuar 7 vite radhazi i cili ka grumbulluar të gjithë nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme të Komunës së Rahovecit dhe ka qenë një ngjarje shumë me rëndësi kulturore dhe inkurajim shumë i madh për artistët e rinj të drejtimit të dramës, nuk është mbajtur. Festivali i muzikës popullore nuk është mbajtur. Kolonia e artistëve në Rahovec ka qenë e para që është organizuar në nivel të Kosovës dhe ka marr karakterin ndërkombëtar, ka qenë e mbështetur prej MKSR, ekziston buxheti i veçantë në Ministri për kolonitë e artistëve në Rahovec, nuk është bërë, nuk është kërkuar. Asnjë ngjarje kulturore klasike nuk është mbajtur, nuk është mbajtur as koncerti i filarmonisë së Kosovës që ata janë në diskonim kurdo që i thirrni dhe pa pagesë. Nuk është kulturë vetëm me folklor, nuk funksionon teatri amator i cili ka funksionuar shumë vite. Galeria e arteve është e licencuar prej Ministrisë së kulturës si galeri e treta në Kosovë, e cila ka validitetin e ekspozimit të arteve profesionale të artistëve me veprat e veta profesionale. Asnjë ngjarje profesionale nuk është mbajtur. Në sport më herët kanë ekzistuar 10 klube të futbollit në Komunën tonë ndërsa tani janë vetëm dy. Tani nuk ka klub hendbolli ndërsa kanë ekzistuar dy, tani nuk ka klub basketbolli ndërsa kanë ekzistuar dy, një i meshkujve dhe një i femrave, tani nuk ka klub volejboli e që kanë ekzistuar dy, tani nuk ka klub boksi dhe kikkë boksit. I referohem raportit se keni bërë kontrata, marrëveshje klubin e Ballkanit dhe Studençanit që është bashkëpunimi shumë pozitiv ndër komunal, mirëpo këtu do të jepni me siguri një arsyetim pse nuk ekzistojnë këto klube të basketbollit ndoshta pse nuk kemi palestër, ja ku është Theranda dhe atje

mund të luajmë. Çfarë rezultate pozitive jeni duke treguar në këtë raport dhe sipas meje kjo është periudhë më e dobët e kulturës, sportit dhe rinisë për Komunën e Rahovecit.

Smajl Latifi – ne jemi dëshmitar e të gjitha zhvillimeve në Komunën e Rahovecit nga paslufta e këndej dhe shumë gjëra që i përmendi Fehmiu mu kujtuan edhe mua, është e vërtetë që Komuna jonë ka pasur mbi 10 klube dhe po ashtu është e vërtetë që tani ka vetëm dy klube të futbollit. Është me interes të përmendet që kudo që kam shkuar në debat publik që për herë të parë zhvillohet në Komunën e Rahovecit dhe kam bërë ftesë publike që të angazhohet rinia, të formohen klubet dhe ne pastaj kemi dhënë zotimet tona që do t'i mbështesim dhe fatkeqësisht janë vetëm dy klube në Rahovec dhe Fortesë. Jam i bindur që KF “Rahoveci” është trajtuar me kujdesin më të madh dhe ne kemi pasur përkushtim të veçantë në mbarëvajtjen e të gjitha aktiviteteve edhe stërvitore por edhe të gjitha lojërave që i ka zhvilluar klubi jonë, madje edhe vetë kam qenë i përfshirë në përpjekje për të mbajtur klubin në Ligë dhe kemi ndihmuar aq sa kemi pasur mundësi edhe me donatorë. Ne jemi të interesuar që në Komunën e Rahovecit përveç KF “Rahoveci” që është me një traditë të gjatë i cili në përbërjen e vet ka një gjithë përfshirje edhe nga lokalitetet e ndryshme të Komunës, të kemi diku rreth 36 klube. Për sa i përket klubeve të basketbollit, të hendbollit, volejbollit e të shahut, është mbajtur një kampionat i shahut dhe ata po përpiqen dhe ne kemi vendos me i përkrah sepse edhe Klubi i shahut ka një traditë të gjatë dhe ka korr rezultate jo vetëm në Komunën e Rahovecit e nivel kombëtar por edhe në nivel ndërkombëtar. Të gjitha iniciativat që lidhen me basketboll, me volejboll, shah ne shprehim gatishmërinë tonë kur ata kanë mundësi me hy në veprime konkrete. Deri te shuarja e klubeve ka ardhur për shkak të vështirësive të ndryshme dhe një ndër vështirësitë kryesore ka qenë financa. Për sa i takon bibliotekës, ne në qoftë se mund të kemi deri në qershor 6 lexues është fatkeqësi e madhe dhe tani a mund të ndërmarrim ndonjë hap për t'i joshur njerëzit që të regjistrohen në biblioteka është një sfidë e madhe sepse ne mund të bëjmë një ftesë publike ndërsa nuk mund të mbajmë përgjegjësi pse nuk janë regjistruar. Është e vërtetë që për herë të parë në Komunën e Rahovecit pas luftës në disa prej aktiviteteve kulturore ose përkujtimore, madje në Festivalin folklorik “Anadrija jehon” SHKA e Rahovecit me kostume kombëtare aq sa ka pajisje ka marr pjesë. Njëri nga motivet të miat dhe kërkesat permanente që i kam pasur te drejtori i kulturës, që ta ngjallim dhe të shtojmë aktivitetin e SHKA në qytet e cila ka pasur dhe do të ketë mbështetjen tonë financiare. Ne jemi të interesuar të aktivizojmë dhe gjallërojmë edhe jetën kulturore, edhe ART studion, Koloninë e artistëve dhe ne kemi bashkëpunim të mirë. Për sa i takon rinisë nesër është Dita e rinisë në Komunën e Rahovecit dhe ë janë planifikuar aktivitete të rinisë nga qendrat rinore, qendrat lokale, OJQ të ndryshme, dhe ne kemi ndarë mjete nga buxheti komunal për ta zhvilluar aktivitetin e tyre në mënyrë sa më të organizuar gjatë ditës së nesërme. Te çështja kush i blen kurorat e flamujt, ne kemi një bashkëpunim edhe me “Ambientin” dhe dikush i blen flamujt e dikush i vendos dhe tani a ja kemi lëndë kodit të Drejtorisë së Kulturës apo Zyrës së kryetarit janë çështje që mund të sqarohen edhe nga auditori i brendshëm. Te Qendra kulturore “28 Maji” në raport është cekur vetëm si shënim dhe mund të jetë gabim teknik, mirëpo më datën 27, 28 dhe 29 ne kemi qenë të përfshirë në shumë aktivitete që lidhen pikërisht me shënimin e ditës të Qendrës kulturore “M. Zyberaj” dhe janë zhvilluar aktivitetet që lidhen me garat e diturisë, janë ndarë edhe çmime etj., mirëpo nuk e di a keni qenë pjesë e këtyre angazhimeve. Për sa i takon raporteve që lidhen me Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, koncerteve të filarmonisë, fondeve të cilat janë të dedikuara në Komunën tonë unë e falënderoj Fehmi Hoxhën që na jep informata shumë të mira sepse unë ju garantoj që prej sot kemi me pasur një qasje shumë më konstruktive, do të vendosim komunikim direkt dhe jemi shumë të interesuar që ti thithim ato fonde të cilat i takojnë Komunës së Rahovecit nga kjo Ministri.

Labiot Berisha – Drejtoria për KSR nuk përfaqësohet në forumet e ndryshme të Ministrisë që mund të ketë edhe përfitime të donacioneve të ndryshme nga organizatat partnerë të Ministrisë së Kulturës që janë, në këtë rast askund nuk është përmendur Ligji për fuqizimin dhe pjesëmarrjen e rinisë i cili Ligj parasheh 4 udhëzime administrative, një ndër to që drejtpërdrejt ka obligime edhe Komuna e Rahovecit e që është U.A. për licencimin e qendrave rinore që në fakt deri më tani ende nuk është marr asnjë nismë apo iniciativë që ky udhëzim të implementohet që është nënshkruar më 12 gusht të vitit të kaluar e që deri më tani të gjitha komunat e kanë zbatuar, ku drejtpërdrejt licencimi bie mbi autoritetin e kryetarit të Komunës duke respektuar vlerësimin nga një Komision që është në Drejtorinë për Kulturë, Drejtori për ekonomi dhe Shoqërinë civile. Kërkoj që kjo çështje të futet në prioritetet të

kryetarit së paku për këtë pjesë të vitit të mbetur, që vitin e ardhshëm të mos mbetet që kjo çështje të mos rregullohet sepse drejtpërdrejt ka të bëjë me jetën dhe mirëqenien e aktiviteteve të rinjve të Komunës së Rahovecit.

Xhemali Haxhimustafa - do të fokusohem te Arsimit sepse kam pritur pak më shumë se sa është këtu, kam pritur që të kemi një farë rezultati të prekshëm edhe për nga numri i nxënësve, ka edhe të atillë që brenda vitit lëshojnë procesin mësues, vetë strukturën, të dhënat më të prekshme dhe njëherësh edhe rreth rezultateve të cilat ka arrit në Komunën tonë që janë pak më shqetësuese se sa në komunat tjera. Mos e merrni këtë diskutimin tim negativ po krejt në suazat e saj që besoj se është interesi i të gjithëve dhe më herët e kemi diskutuar dhe kemi kërkuar nga ish drejtorët të kemi këto të dhëna numerike për të ditur si të shkohet më tutje. Është një term i cili përdoret këtu dhe më la mbresë pak a shumë rreth këshillave dhe bordit dhe sa e di unë këshilli është bord dhe nuk kemi nevojë me e përdorë atë fjalë se është Këshill një organ i cili është pranë një institucioni të caktuar. Është brengosëse nëse dy herë përmendet ku thotë ka filluar funksionalizimi i bordeve apo këshillave nëpër shkolla. Në qoftë se nuk kanë funksionuar këto është shumë keq për arsye se sa e di unë në një këshill të një shkolle shumë është varur nga drejtori dhe nga anëtarët të cilët kanë qenë të përkushtuar. Këtë e them si qytetar dhe si prind se Këshilli i shkollës në bazë të asaj se cilat funksionet i ka, është në një farë mënyre promotor i ngritjes së efikasitetit të punës edhe të drejtorit dhe të arsimtarëve, por normal edhe të ngritjes së disiplinës nëpër shkolla. Raporti për të cilin do të jap vlerësimin është ai i Shëndetësisë dhe mirëqenies sociale i cili raport ka të dhëna të prekshme dhe është raport korrekt, sepse kur ceken në një raport objektivat e ardhshme është një raport të jep qasje dhe të dhëna që për të ardhmen mund të përcjellësh dhe mund të marrësh çështje konkrete. Të gjitha drejtoritë e kanë rolin dhe rëndësinë e vet, mirëpo Drejtoria e arsimit, Drejtoria e shëndetësisë pak a shumë veçohen nga drejtoritë tjera për arsye se kanë gati tërë popullatën e komunës tonë klientelë si dhe në mënyrë direkt apo indirekte merr pjesë në mirëvajtjen e punëve të këtyre drejtorive. Unë besoj se në të ardhmen do të kemi raporte më informative sepse që në fillim e thamë që ky raport nuk votohet, por është mirë që nëpërmjet këtij raporti të marrim informacione të prekshme, të sakta të cilat mund të transmetohen te qytetarët e interesuar në lëmit e ndryshme që të kemi shënime më të sakta dhe më përmbajtjesore.

Lumturije Hoti – gjatë debatit publik në Krushë të Madhe ka pasur vështirësi Projekti te Drejtoria për Shërbime Publike për lagjen e Gashve dhe e Romëve, sepse në fillim është nisur pa anësorët ndërsa tani ato janë vendos, mirëpo ka vërejtje nga qytetarët ngase kubëzat lëvizin për shkak se në fillim është startuar pa anësorët. Kryesia e fshatit më ka informuar që ky Projekt nuk është marr për sipër nga qytetarët për gjysmën e parë ndërsa për pjesën e dytë qytetarët e marrin përgjegjësinë si Kryesi e fshatit.

Rukije Krasniqi – duke analizuar raportin e Qeverisë komunale dhe analizë të veçantë i bëra Drejtorisë së arsimit të Komunës sonë, sepse është një Drejtori ku frekuentojnë me qindra e mijëra nxënës si dhe mësime të ndryshme, do të thotë që kërkon një përkushtim edhe pse drejtoresha është shumë punëtore, me përgjegjësi të madhe dhe ka bërë një punë mjaft të mirë duke kursyer buxhetin e Komunës për 1/3 e buxhetit, duke marr nga donatorët e jashtëm rreth 800.000 € të cilat investime janë bërë kryesisht në infrastrukturën shkollore. Kam një kërkesë që duke marr parasysh situatën e arsimit të Komunës tonë por edhe më gjerë, ne duhet të bëjmë përpjekje për evitimin e dukurive devijuese si dhe eliminimin e disa shkaqeve që kanë sjellë dhe mund të sjellin në të ardhmen shqetësimet serioze në shkollat tona. Dukuritë e duhan pirjes, abuzimi me narkotikë dhe dukuritë tjera jo sociale na bëjnë të mendojmë seriozisht për zgjidhjen e disa problemeve. I propozoj këtij Kuvendi që të miratoj një Rregullore kod veshje në shkollat fillore dhe të mesme i cili kod do të përmbajë kushte të caktuara të paraqitjes fizike të nxënësve por edhe të mësime të ndryshmeve. Kodi i propozuar duhet të përcaktoj mënyrën e veshjes, mbajtjes së aksesoreve, vathëve, unazave e të tjera si dhe mos lejimit të tatuazheve nga ana e nxënësve dhe mësime të ndryshmeve. Gjithashtu ky kod i etikës do të përmbajë detaje në veshje në shkollat tona nga ana e djemve dhe vajzave, duke bërë që dukja e tyre fizike të ketë në rend të parë, eliminimin e paraqitjes së panderë të nxënësve në shkollat tona. Me këtë mund të shpresojmë se në shkollat tona do të rritet disiplina, që do t'i përngjaj më shumë institucionit arsimor-edukativ, në mënyrë që të përmbushet sa më shumë misioni primar që ka shkolla. Në këtë mënyrë do të mundësohej që mësime të ndryshme të kenë mundësi të veprojnë në përputhje me këtë rregullore ose me kod të etikës së veshjes si dhe do të krijohej një lehtësi në vënien e kontrollit të sjelljes së nxënësve në

shkollë. Kërkoj që nga DKA që të angazhohet në përpilimin e një rregullore në mënyrë që në një nga mbledhjet të radhës ta mund të diskutojmë dhe ta miratojmë.

Rasim Fazliu – në faqen 3 ku shkruan: angazhimi permanent për gjetjen e zgjidhjes për tregtimin e rrushit dhe prodhimeve të rrushit në tregun vendor dhe ndërkombëtar, mirëpo nuk është përfshirë edhe për perimtarinë ngase është i njëjti problem dhe është dashtë të ceket dhe të merret në konsideratë. Në faqen 4 – përpjekjet tona për mbrojtjen e shtratit të Drinit të bardhë dhe parandalimin e tokave bujqësore, është dashur të thuhet në mënyrë më konkrete se çka është ndërmarr. Në faqen 6 – e dimë që Njësia e auditorit të brendshëm është me karakter këshillëdhënës dhe më tepër është marr me auditimin e punës për vitin 2010 dhe nuk po shoh këtu që ka punuar në këtë drejtim, që kur vjen auditori gjeneral mos të del me pengesa dhe të gjetura, por ajo këshill dhënie të jetë gjatë vitit këtu dhe të mos ketë vërejtje. Në fq. 20 që ka të bëjë me kontrollimin e kompjuterëve nëpër shkolla, është punë shumë e mirë që është kryer, mirëpo kisha një sugjerim që ai që merret me këtë çështje që kemi edhe fotokopjuesit nuk janë furnizuar me toner adekuat që pastaj paraqiten probleme sepse nuk funksionojnë si duhet prandaj duhet të funksionalizohen. Në fq. 25 – vizita sistematike nxënësve nëpër shkolla, këtu është cekë vetëm që do të organizohen vizita sistematike, mirëpo nga përvoja e dijë që para shumë vite ka pasur vizita sistematike ndërsa viteve të fundit është ndërprerë kjo çështje, mirëpo është mirë që kjo të realizohet dhe atë sa më parë me qëllim të mbrojtjes së shëndetit të nxënësve. Në po të njëjtën faqe - mbeturina medicinave dhe barna me afat të skaduar. Barnat me afat të skaduar janë një çështje shumë serioze dhe shumë e ndjeshme dhe nuk guxojmë tolerant që ato të qarkullojnë në barnatoret tona dhe popullata të furnizohet me ato.

Salih Hoti – përmbajtja e raportit ngadhënjyese prej raporteve të deritanishme që kemi pasur në Kuvend, risi është se është përfshirë raportimi i Njesisë së auditimit të brendshëm, gjë që në të kaluarën asnjëherë nuk kemi pasur. Këtij raportit i mungon edhe një raport që ka qenë dashtë të jetë e ai është i Avokaturës publike komunale. Në raport kam hasur në disa çështje për të cilat konsideroj që janë të rëndësishme sidomos sa i përket sfidave ku janë shpalos në mënyrë të konsiderueshme sfidat me të cilat është ballafaquar kryetari bashkë me stafin e tij. Disa sfidave është dashtë dashur me i kushtuar më tepër rëndësi si që është çështja e menaxhimit të aseteve ngase siç e di që menaxhimi i aseteve në Komunë bëhet një herë në vit, por konsideroj se deri tani të paktën nuk kemi marr informacion se ky menaxhim a ka përfshirë vetëm Administratën komunale apo edhe varësit e sajë, shkollat dhe shëndetësinë, për shkak se këto dy njësi janë varëse të KK së Rahovecit dhe nëse nuk janë përfshirë atëherë për herën tjetër të kihet parasysh ngase inventari i tyre janë pasuri e Komunes dhe doemos duhet të regjistrohen me qëllim që të mos vijë deri te shmangja e ndonjë numri të caktuar të inventarit. Për arsim kam parë disa sfida që ka përmendur drejtoresha por nuk është përmendur cilësia e notimit të nxënësve. Ju keni periudhat kur duhet të notohen nxënësit, në gjysmë vjetorin e parë dhe të dytin, pastaj janë dallime shumë të thella rezultatet e gjysmë vjetorit të parë dhe të dytë në të gjitha shkollat. Ose aspekti tjetër, deri para tri javë pa përfunduar viti shkollor është një vlerësim krejt tjetër i nxënësve dhe konsideroj se kjo nuk është fare objektive. Propozoj për të ardhmen që arsimtarët që i notojnë nxënësit në fletoret personale dhe në periudhë të caktuar nuk i vejnë notat në ditar të kenë parasysh që kjo të mos mundësohet në këtë formë për shkak se ai ka mundësi me qitë një notë jo objektive në fund dhe mos me u vërejt në ditar. Propozoj që ditarët në periudha të ndryshme të skanohen dhe aty ku konstatohet se ka parregullsi të merren masa ndaj atyre që kanë bërë ato parregullsi. Në Drejtorinë për Shërbime Publike Komunale thuhet që sipas planit mujor ceket përqindja e realizimit, nuk mund të dimë se sa është e saktë kjo dhe nëse ne nuk kemi planifikimin dhe realizimin gjashtëmujor, tek atëherë mund të nxirret përqindja e realizimit të caktuar të planit investues. Në Zyrën e tatimit në pronë është një konstatim që keni shpërndarë rreth 10.300 fatura ndërsa rreth 3.000 janë realizuar që do të thotë diku rreth 29.6% e të hyrave të grumbulluara për 6 muaj dhe nëse shkohet me këtë dinamikë deri në fund të vitit realizimi do të jetë diku rreth 60% që është shkallë e ulët. Sa i përket Drejtorisë të Administratës kam parë një angazhim të mirëfilltë dhe përmbajtjesor të menaxhimit, rendit shtëpiak dhe punës që është bërë në skanimin e librave të amzës dhe çështjet tjera me interes. Në përgjithësi raporti i përmbush kriteret cilësor që duhet të ketë me përjashtim të disa çështjeve me të dhëna të tepërta e diku më të mangëta ndërsa pjesa tekstuale është e pranueshme ndërsa në pjesën e të dhënave financiare mungon një qartësi për të ditur më qartë sa është planifikimi dhe realizimi dhe për të ardhmen kjo të kihet parasysh.

Feim Fetoshi – një raport nuk duhet të matet nga ajo se si është shkruar, por duhet të matet sa nga kjo punë që është shkruar këtu, kanë përfituar qytetarët për të cilat punohet. Kam përshtypjen që në këtë gjashtëmujor qytetari i Komunës së Rahovecit nuk ka parë ndryshime pozitive në raport me të kaluarën dhe qytetari i Komunës nuk ka shiju pritjet të cilat i ka pasur nga kjo Qeveri. Po përmendi shkurtimisht që janë si më qenësore dhe esenciale që nuk janë përmendur deri tani. Qytetari i Rahovecit vazhdon të vuaj nga mungesa e ujit, shtrati i lumit të Drinit të Bardhë vazhdon të degradohet në mënyrë shumë të egër, nuk shihet asnjë përmirësim por thellohet keqësimi i mbrojtjes së ambientit, në Administratë nuk shoh ndonjë përmirësim. Fakti që aparatura që është në korridorin e Komunës 5 muaj nuk është përdorur fare dhe sipas informatave që kam, kur ka ardhur personi për servisim drejtori është përgjigjur se nuk kam ditur se për çka është kjo që tregon për një jo seriozitet. Posaçërisht brenga e popullatës është arsimi sepse vazhdon të lëngoje gjatë dhe ky Kuvend komunal në këtë periudhë qeverisëse ka diskutuar shpesh për problemet në arsim dhe për fat të keq asnjëherë nga këto probleme për të cilat ne kemi biseduar nuk janë në këtë raport, as si lëvdatë që është punuar por as si sfidë që duhet të punohet dhe që nuk është kryer. E inkurajoj kryetarin e Komunës që të bëjë një angazhim më të mirë të stafit të tij që puna qeverisëse të fillon të preket nga qytetari i mbarë Komunës së Rahovecit.

Nahit Elshani – u tha që raporti është mjaft voluminoz por në format është i mirë, mirëpo mendoj që kjo që është shkruar këtu e ka ngarkuar këtë raport për faktin se në rendin e ditës shkruan qartë se është shqyrtimi i Raportit të Kryetarit të Komunës për situatën ekonomike financiare dhe për programet investuese që i ka pasur komuna. Është dashtë që kryetari që nga ky raport të bëjë një përmbledhje më të shkurtër ku do të paraqiste qartë punën e bërë gjashtëmujore sidomos kur ka të bëjë me çështjen e realizimit e të hyrave dhe shpenzimi i buxhetit, realizimi i projekteve të cilat kanë qenë si prioritet i Komunës. Në raport ka qenë mirë të jenë edhe vendimet që i ka marr kryetari i Komunës gjatë kësaj periudhe qeverisëse, sa kanë qenë të mira dhe fitimprurëse për qytetarët e Komunës, ka qenë dashtë të na prezantoj mënyrën e punësimit që ka bërë në Administratën komunale sepse konsiderojmë se punësimi është bërë sikur edhe në Qeverinë e kaluar në baza partiake, shoqërore, familjare, thjeshtë konsideroj se ka pasur nepotizëm të çështja e punësimit. Nuk është **paraqitur asgjë sa i përket disiplinës në punë pos që ka thënë që është ngritur disiplina në punë, a ka pasur ndonjë rast ku janë ndërmarr masa ndaj ndonjë punëtori për shkelje të ligjit apo për mosrespektim të kodit të mirësjelljes apo të orarit të punës. Nuk paraqitë askund çështja e pronës komunale, sa është dëmtuar dhe sa është uzurpuar në kohën e qeverisjes së kryetarit të Komunës dhe të paraqet si objektivë në të ardhme se çka do të bëhet për parandalimin e uzurpimit të pronës komunale. Po ashtu ka qenë dashtë të jetë në këtë raport edhe aktivitetet që kryetari i Komunës ka ndërmarr për parandalimin e ndërtimeve pa lele në Komunë. Çka është ndërmarr ndaj operatorëve të pa përgjegjshëm të cilët kanë kontratën me Komunën për shfrytëzimin e pronës komunale dhe të cilët nuk paguajnë qiranë. Po ashtu në këtë raport nuk është prezantuar për veprimet që janë ndërmarr, nëse janë ndërmarr, ndaj operatorëve të cilët nuk kanë punuar konform planit dinamik të punës rreth kryerjes së projekteve. Një rast konkret do të përmend, a është ndërmarr diçka ndaj operatorit i cili e ndërton kolektorin kryesor në Krushë të Madhe dhe Hoçë të Madhe. Janë përmendur rrugët fushore edhe në të kaluar por edhe tani, këto rrugët fushore shkojnë vetëm ku ja merr mendja drejtorit e që kjo çështje më tepër duhet t'i lihet Kuvendit në mënyrë që t'i caktoj prioritetet. Në raport përmendet respektimi i vlerave kombëtare njerëzore dhe mirëmbajtja e varrezave si dhe përmendoreve të dëshmorëve, nuk e di se cilat varrezat janë mirëmbajt dhe është mirë që të na thuhet nëse ka diku që janë mirëmbajtur varrezat e dëshmorëve dhe përmendoret dhe në fund që dua të them si kontinuitet nga Qeveria e kaluar është favorizimi i bizneseve jashtë Komunës me rastin e dhënies së tenderëve, që është një gabim, se ne dimë këtu të vjelim taksa nga këto biznese që i kemi dhe thjeshtë në kushtet e barabarta duhet t'ju japim mundësinë bizneseve tona e jo të komunave tjera dhe këtë duhet të kemi parasysh.**

Ilirjana Gashi – kam një vërejtje të Drejtorisë për punë inspektuese në inspektimin e marketeve që gjenden në qytet sepse këtu thuhet që janë asgjësuar produktet e ushqimit, mirëpo në produktet e marketeve tona gjenden produkte që kanë brenda insekte dhe atë e them me bindje të plotë. Cilat janë masat që po i ndërmerrni apo inspektimi bëhet shkelje dhe shko sa për të thënë se është bërë inspektimi.

Kësaj çështje duhet kushtuar kujdes më të madh sepse banorët e Komunës nga aty ushqehen dhe mund të ketë pasoja më të mëdha.

Avdullah Kryeziu – në Zyrën e prokurimit është respektuar Ligji mbi prokurimin publik dhe sipas të dhënave që i kemi këtu del që në bazë të Ligjit operatorë më të lirë e kanë marr tenderin dhe prej të gjitha aktiviteteve të prokurimit del që janë kursyer diku rreth 130.000 €. Me siguri kryetari i Komunës këto mjete do t'i dedikoj në projektet të cilat janë të rëndësishme për qytetarë të Komunës së Rahovecit. Drejtoria për Shërbime Publike Komunale dhe Emergjencë nga e cila kemi disa të dhëna, shpresoj të jenë të sakta, sepse do të përmendi vetëm një rast të kanalizimit në fshatin Retijë, ku përfituesi është operatori ekonomik "Iliri-NA" nga Prizreni, punimet duhet të fillojnë në gusht ndërsa sot jemi më 12 shtator e punimet ende nuk kanë filluar. Kam cekë që për këtë fshat ka qenë edhe tenderi për furnizimin me ujë të pijes dhe këtë brengë të qytetarëve e kam përcjell edhe më herët tek ju, ju keni garantuar që edhe fazën e tretë të ujit të pijes do ta kryeni në fshatin Retijë, por nuk kam parë askund që keni shpallur tender ose keni zotuar mjete për këtë tender që ka qenë prej vitit 2008 dhe faza përfundimtare e ujit të pijes për këta banorë ende nuk është kryer. Sa i përket raportit të Drejtorisë për shëndetësi e falënderoj drejtoreshën që i ka cekur të gjitha të metat të cilat kanë qenë dhe ato kanë filluar të përmirësohen në Drejtorinë e shëndetësisë. Në Drejtorinë e bujqësisë në fq. 37 thuhet hartimi i një strategjie për turizmin e verave të Komunës së Rahovecit e në fund thuhet mungesa e strategjisë zhvillimore dhe kjo duhet të përmirësohet. Në fq.38 te pranimit i aplikacioneve për grande qeveritare, në fund të realizimit thotë kemi përgatitur dhe dorëzuar 247 aplikacione, ku janë dërguar këto aplikacione? Duhet të ceket ministria përkatëse ose diku tjetër. Po ashtu në fq. 39 thotë përcjellja e fushatës e të mbjellave pranverore, kulturat bujqësore, realizimi, mbjellja e kulturave pranverore. Sa sipërfaqet janë mbjell, cilat sipërfaqet janë dhe raporti duhet të jetë detal. Nëse kanë përcjellë fushatën pranverore atëherë duhet të dihet edhe sipërfaqja sa është mbjellë në Komunën e Rahovecit e që nuk është përfshirë në raport. Po ashtu aty ku përmendet vrojtimi i rrugëve fushore dhe caktimi i tyre sipas prioriteteve për rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre, realizimi, jemi duke bërë para masat për këto rrugë fushore. Para masat janë bërë, por cilat rrugë fushore po rinovohen dhe po rregullohen dhe këto i mungojnë raportit. Në fq. 42 thuhet aplikimi i fermerëve në grande në masën për bagëti të imta, pastaj aty menjëherë thuhet, debati i hapur me bujqit dhe ministrin e Ministrisë të bujqësisë, tregtisë, industrisë dhe cekni heqjen e akcizës bujqësore ndërsa ju nuk jeni faktor e as Qeveria komunale që i heq akcizat dhe barrierat doganore, por është dashur të ceket bashkëpunimi me ministrinë përkatëse për heqjen e barrierave doganore dhe akcizës së verave.

Smajl Latifi – disa vërejtje, sugjerime dhe kritikë të cilat janë dhënë janë të arsyeshme ose kanë për motiv mungesën e informatave dhe i ftoj të gjithë këshilltarë të KK-së që Ligji për qasje në dokumente zyrtare vlen edhe për qytetarët e Komunës e mos të flasim për këshilltarët. Për çdo çështje për të cilën ju keni nevojë që të jeni të informuar saktësisht, dyert e Komunës së Rahovecit janë të hapura dhe aty mund t'i shihni në detaje të gjitha gjëra të cilat kanë të bëjnë me periudhën qeverisëse janar-qershor 2011. Kur përmenden para masat sipas planit dinamik rrugët fushore duhet të shtrohen dhe trajtimi do të filloj në gusht dhe shtator. Kjo do të thotë që Drejtoria e bujqësisë ka punuar me ekspertët e saj në rrugë të ndryshme fushore, po ne kemi adresuar ose kemi marr për bazë ato rrugë të cilat vetë komuniteti i ka trajtuar me prioritet. Në të gjitha debatet me qytetarët të cilat ne i kemi zhvilluar një nga temat ka qenë trajtimi i rrugëve fushore sepse ka qenë kërkesë dhe shqetësim i vetë qytetarëve sepse siç e dimë Komuna jonë është Komunë që merret me bujqësi. Te Zyra e prokurimit është e vërtetë që shefi i ZP zyrtarisht i raporton kryetarin të Komunës, mirëpo kryetari nuk ka asnjë angazhim konkret në kuptimin e ndërhyrjes në Zyrën e prokurimit dhe ju mund të vërtetoni këtë. Të gjitha ndërhyrjet e kryetarit janë me qëllim që të jetë më funksionale, të mos ketë vonesa, ngecje, të mos ketë jo funksionalitet dhe kam kërkuar vazhdimisht që t'i përmbahemi planit dinamik dhe të kryen rolin që e ka si ZP. Është e vërtetë që ky raport është ndryshe nga raportet e gjertanishme prandaj po debatohet në mënyrë shumë më përmbajtësore sepse është më i zgjeruar, por maksimalisht jemi mundësuar me paraqitë qartësisht pozicionin e autoriteteve të Komunës gjatë kësaj periudhe. Drejtoria për KRS do të ishte shumë e motivuar që të ketë qasje dhe bashkëpunim konstruktiv edhe me MK SR dhe të shfrytëzojë të gjitha ato mundësi dhe rrethana lehtësuese në kuptimin e investimeve por edhe të organizimit të aktiviteteve të ndryshme si në rini, sport dhe kulturë. Projekti te lagja e Gashëve dhe Romëve, është e vërtetë që ky projekt ka munguar për shkak se arsyetimin të cilin e kanë bërë

projektuesit se anëtorët janë të kushtueshëm, mirëpo ne e kemi pa që një rrugë me kubëza nuk mund të jetë si projekt cilësor dhe i qëndrueshëm në qoftë se nuk ka anëtorë dhe kemi ndërhyrë. Do të vazhdojë kjo rrugë deri te lagja e Romëve dhe do ti përmbushim obligime që i kanë qytetarë të asaj zone. Veprimet e Qeverisë gjatë kësaj periudhe janë të prekshme, janë konkrete, natyrisht ne jemi në lëvizje në terren, ka përmirësime sepse jemi të angazhuar thellësisht që t'i shfrytëzojnë maksimalisht mundësitë që i kemi dhe ndryshimet vërehen kudo në Komunë por në qytetin e Rahovecit jemi pak prapa në zhvillimin e projekteve, mirëpo edhe në qytet do të ndërhyjmë shpejtë dhe do të ketë ndryshime në dy-tri projekte minimum. Ne dëshirojmë që të kemi bashkëpunim të hapur dhe shumë konstruktiv me të gjithë këshilltarët e Kuvendit komunal që t'na japin informatën dhe njoftojnë nëse ka ndonjë defekt për të ndërhyrë. Sa i takon kolektorit të ujërave të zeza, është e vërtetë që kemi operatorë të përgjegjshëm dhe mos të harrojmë që ne e kemi trashëguar një gjendje dhe nuk është lehtë me prish kontratën me dikë, por shpresoj që operatori do të vazhdoj punët dhe do t'i kryej. Ai ka hasur në një pengesë në fshatin Nagac por shpresoj që në bashkëpunim me komunitetin dhe me neve do të vazhdoj punën dhe faza e dytë e këtij projekti është shpallur tenderi dhe shpresojmë që ato mjete të cilat do ti fitoj do të shkojnë në destinacionin e duhur dhe të kryhet puna si duhet. Vërtet është duke u zhvilluar një projekt i rëndësishëm dhe është duke u vazhduar implementimi i atij projekti i fituar si grand i Komisionit evropian në pikën grumbulluese në Xërxë. Janë hapur edhe dy pika grumbulluese në Krushë të Madhe dhe në Denjë dhe natyrisht që nuk mund t'i zgjidhim këso farë probleme këtu, por më shumë jemi përqendruar në problemin e rrushit e të verës për shkak se u krijua një problem i madh në vitin e kaluar dhe në këtë drejtim kemi marr hapa konkrete ku i jemi adresuar Ministrisë së bujqësisë dhe kemi bërë një punë të mirë të përbashkët edhe me Shoqatën e venarëve dhe të vreshtarëve si dhe pronarët e bodrumeve. Kemi bërë dy kërkesa në Ministri: kërkesë për subvencionim në çmim dhe kërkesa për kompensim të dëmeve të shkaktuara nga bora dhe ngricat e fillim prillit të këtij viti. Shpresojmë që të kemi mundësi me përfitua fermerët nga Ministria e bujqësisë. Te çështja e akcizës ne kemi bërë kërkesë në Ministrinë e bujqësisë që të ndërmerren hapat konkrete që sa më shpejtë të hiqet akciza dhe barrierat doganore, sa më shpejt të ndërmerren masat konkrete në mënyrë që të përfitojnë fermerët tanë. Janë dërguar 247 aplikacione në Ministrinë e bujqësisë dhe lista e shumave të grandeve të fituara është 314.000 €. Pse përfitojnë tenderët operatorët jashtë komunës tonë, publikisht e them që është më mirë me i ndihmua operatorëve të Komunës tonë, mirëpo edhe ne kemi probleme me Zyrën tonë të prokurimit siç kanë probleme edhe të gjitha komunat tjera. Sa i përket nepotizmit nga familja ime nuk punon askush në institucionet e Komunës së Rahovecit dhe unë nuk veproj në baza partiake dhe mund të shihni se anëtarët e cilave parti po përfitojnë më së shumti, por një e di që qëllimi ynë është që asnjë njeri të mos punësohet pa konkurs. Në fund ju falënderoj për përkushtimin tuaj, për kontributin, vërejtjet, kritikën, rekomandimet që dhatë në mënyrë që ne vazhdimësi ta përmirësojmë kualitetin e punës tonë, sepse vetëm në këtë mënyrë përfitues i vetëm i gjithë kësaj do të jetë qytetari i Komunës së Rahovecit.

Kryesuesi – konsideroj që çdoherë ka hapësirë për vërejtje dhe sugjerime, të gjitha këto vërejtjet e juaja ishin konstruktive dhe kishin për qëllim që puna në Komunën e Rahovecit të përmirësohet dhe të jetë më e mirë për qytetarin e saj. Prandaj duke pasur parasysh që ky është raport 6-mujor në raportin njëvjeçar aty do të paraqiten tabelarët dhe krahasimet me punën e viteve tjera, prandaj e shoh të arsyeshme që tani të kalojmë në pikën e radhës.

4. Informatë nga Drejtoria e Arsimit mbi përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor 2011/2012.

Besa Hoxha-Beqiri, drejtoreshë e DKA – ka informuar këshilltarët mbi përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor 2011/2012 e cila informatë do t'i bashkëngjitet procesverbalit.

Labiot Berisha – çështja e nxënësve të cilët janë përjashtuar dhe për të cilët është përfolur shumë dhe këtu nuk bëhet fjalë si numër, si sasi, por për çështjet e drejtave të njeriut, çështjet fundamentale e të drejtave të fëmijëve dhe këtu ka shkelje të rënda. Këtë e argumentoj sepse jam i certifikuar nga Zyra e Gjenezës për çështje të monitorimit të konventave për të drejtat e fëmijëve. Një njërën e seancave këtu është marr një vendim që kjo çështje t'i delegohet kryetarit të Komunës dhe Drejtorisë. Por ndër këto çështje po i referoheni dispozitave pozitive në këtë rast Udhëzimit Administrativ i cili shkruan shumë qartë që institucionet në këtë rast Komuna, Drejtoria, është e obliguar të informoj prindërit e fëmijëve për ata që janë larguar. Është marr një vendim që këtyre fëmijëve t'iu mundësohet mësim alternativ, por nuk është bërë, është marr obligim që të informohet për këta fëmijë, nuk ka ndodhë.

Është manipuluar Kuvendi komunal në seancën e parë kur është diskutuar për çështjen e fëmijëve. Është raportuar për numrin 30, por ky numër ka qenë i të larguarve në SH.M. në fshatin Ratkoc ndërsa ky numër në emër të koefidencialitetit të emrave të fëmijëve është përdorur që 22 janë suspenduar në SH.M. “Xhelal Hajda-Toni” në Rahovec ndërsa 7 në Ratkoc. Me sa mësova këta fëmijë e kanë humbur vitin dhe nuk është që ata e kanë humbur por ju ua keni humbur vitin dhe mundësinë. Nëse janë përjashtuar 30 në Ratkoc shtrohet pyetja kush e ka pasur atë të drejtë humane që 7 t'i largoj. E kuptoj që një pjesë e atyre fëmijëve janë edhe delikuent dhe që vërtet nuk e meritojnë të jenë në banka shkollore, por sikur të raportohet si sot për çdo muaj, ju siguroj se nuk kishte ardhur deri te kjo situatë.

Feim Fetoshi – e dëgjova me vëmendje raportimin e drejtoreshës, u thanë fjalë shumë të bukura dhe sikur të ishin këto realitet, atëherë ne do të mendonim që po jetojmë diku në Suedi apo Norvegji dhe jo në Kosovë. Unë vetëm dy çështje po i them zonjës, harroi këtu të raportoj për punësimin gjoja në emër të dhënies së orëve dhe atë me 100% nepotizëm që po bëhet. Drejtoresha e Gjimnazit që nga ardhja e saj ka punësuar burrin, kunatën dhe në këtë vit me lejen e drejtoreshës të DKA-së, në emër të dhënies së orëve ka punësuar edhe kunatën pra motrën e burrit tjetër. Nëse zonja thotë që nuk di, është shumë iluzore sepse këtë i gjithë Rahoveci e di sepse edhe kafet e mëngjesit i pinë së bashku, pra është nepotizëm. Po ashtu dihet që Rahoveci ka pasur një problem në fund të vitit shkollor për punën e ekskursioneve dhe gjeneza ka qenë që fëmijët kanë rezistuar që ekskursioni të shkoj përmes të preferuarve të drejtoreshës së Gjimnazit e cila punon në bashkëpunim me drejtoreshën e DKA-së dhe kur kanë parë që fëmijët vetë dëshirojnë të organizohen, ka lindur ky problem. I njëjti problem rrezikon të përsëritet edhe tani. Ju informoj se kam informacione të sakta se tani në fillim të vitit të ri shkollor maturantët e rinj dëshirojnë të organizojnë ekskursion. Drejtoria e arsimit dhe drejtoresha e Gjimnazit ju kanë thënë që duhen të organizohen me 100% të mjeteve të vetë nxënësve, mirëpo më duket jashtë çdo norme ligjore dhe morale që me mjetet e nxënësve të manipulohet. Është shpallur tenderi dhe nxënësit kanë kërkuar që të jenë ata prezent në hapjen e tenderit dhe të shohin se kush po konkurron, ndërsa urdhri i drejtoreshave është që vetëm ata ligjërisht janë kompetent t'i hapin oferta dhe të vendosin se kush do të fitojë tenderin për ekskursionin e nxënësve edhe pse 100% ai ekskursion financohet nga vetë nxënësit. Këto thënie mund t'i vërtetojmë edhe tani në shkojmë në shkollë.

Smajl Latifi - kam informacione të bollshme se cilat kanë qenë qëllimet e organizatorëve qoftë brenda shkollave të caktuara apo jashtë shkollave. Unë ju siguroj që ka elemente që kanë dashur të përfitojnë pa lejet përkatëse dhe kam ndërhyrë dhe nuk kam lejuar që të ndërhyjnë në shkolla. Nuk jam duke folur për shkeljen e të drejtave të fëmijëve sepse ne e dimë se ku shkelen të drejtat e fëmijëve, si mbrohen fëmijët dhe jeta e tyre. Është e vërtetë që një pjesë të përgjegjësisë mund të kenë edhe drejtorët shkollave sepse ata i kanë disa të drejta në kuadër të planifikimit, por esenciale është që veprimet e paligjshme, shkeljet eventuale, ne jemi të interesuar me i eliminuar dhe normalisht të funksionoj procesi edukativo arsimor shkollat fillore dhe ato të mesme. Për nepotizëm, ne jemi në Kosovë, mund të ketë edhe veprime të këtilla, mirëpo ne nuk mund apriori të mbajmë përgjegjësi në qoftë se na ndodhin veprime të tilla në një nga institucionet publike, jemi të interesuar me i ndjekë procedurat, me i respektuar ligjet e në fund të fundit konkurrenca është konkurrencë. Është e vërtetë që ky Kuvend e ka debatuar çështjen e pezullimit të nxënësve, është e vërtetë që ka mungesë të rregulloreve por tani është aprovuar edhe Ligji për arsimin para universitar dhe shpresojmë të hyjë në fuqi së shpejti dhe do të kemi mundësi të nxjerrim rregullore që i specifikojnë shumë më mirë edhe rolin e mësimdhënësit, të drejtorit, të nxënësit, të këshillave të shkollave dhe me këtë do të jenë më funksional mekanizmat që kanë të bëjnë me arsimin para universitar.

Besa Hoxha-Beqiri – mandatin e kam marr më 1 shkurt ndërsa para kësaj është bërë pezullimi i nxënësve për shkak se asnjë drejtor dhe asnjë drejtori nuk ka të drejtë të përjashtoj por pezullon. Me vendimin që kam sjellë nxënësit që janë pezulluar për shkak të mungesave kam kërkuar që të informohen prindërit dhe nxënësit dhe të bëhet transferi i tyre në dy shkolla tjera të mesme ndërkaq vendimi për pezullim i marr në këtë Kuvend, ka qenë për nxënësit e SH.M. “Xhelal Hajda – Toni” dhe disa nxënës të SH.M. “12 Maji” të cilët nuk kanë vijuar 1/3 të mësimin në bazë të U.A. dhe ligjit. Këta nxënës i janë nënshtruar mësimëve klasore, nuk iu është humbur e drejtë e mësimin të mësimëve

klasore dhe një pjesë e tyre e kanë kaluar. Sa i përket punësimit gjoja të orëve të kumatës të drejtoreshës kjo nuk është e vërtetë. Për ekskursionin e maturantëve është bërë shpallja dhe përpara është praktikuar që në hapje të ofertave të jenë dy përfaqësues të arsimit, drejtorë të tre shkollave dhe të gjithë ofertuesit prezent. Në qoftë se është çështje e cila mendoni që mund të ketë probleme unë ju siguroj që në hapjen e këtyre ofertave do të jetë edhe përfaqësuesi i maturantëve i të tre shkollave. Për rezultatet e detajuara që nuk janë sjellë sot, siç u cekë nga kryetari më 31.08. përfundon viti shkollor dhe kjo ka qenë arsye që statistikën nuk kanë qenë të vendosura në informatë për shkak se statistikën përgatiten prej 15-20 shtator. Mirëpo, që të mos bëhen manipulime në kemi bërë fotografimin e ditarëve dy javë para përfundimit të vitit shkollor ku janë parë manipulime dhe ndryshime të notave dhe tani është procedura ku inspektorët do të merren me këtë dhe do të presim raportin prej tyre.

Burim Krasniqi – shkuarja në Shqipëri e maturantëve në fillim të vitit, a mos po e ç'rregullon sistemin sepse një pjesë e madhe e arsimtarëve të shkollave të mesme tani po mungojnë.

Besa Hoxha-Beqiri – është një temë të cilën e kam diskutuar me drejtorët e shkollave për shkak se ka qenë sugjerimi edhe nga unë që ekskursioni të mbahet në prill ose në maj duke menduar që atëherë do të jetë më efektiv, arsyetimet e tyre janë që periudha e prillit dhe majit është shumë e ngarkuar ku nxënësit duhet të përgatiten për provim të maturës dhe kanë shpenzime për mbërme të maturës.

Fane Thaçi – ne të gjithë e dimë se kemi të drejtën e lëvdave dhe të kritikave, mirëpo në qoftë se kritikojmë duhet të kemi argumente dhe fakte sepse për një drejtoreshë të arsimit siç është duke i kryer punët, është për çdo lëvdatë. Çdo vendim që merr është në përputhje me ligjin mbi Arsimin.

Rasim Fazliu – puna në Arsim është shumë më komplekse se sa ne këtu mendojmë disa, për shkak se është numri shumë i madh i nxënësve, i arsimtarëve dhe i shkollave dhe konsideroj që DKA ka pak punëtorë për menaxhim kështu që duhet të rritet numri i punëtorëve për të menaxhuar situatën sa më mirë. Për fillim nuk mund të mohohen rezultatet që janë arritur në Arsim pavarësisht nga ajo që ka edhe lëshime, mirëpo rezultate ka dhe janë evidente por mund të bëhet edhe më mirë. Ekskursionet janë të rregulluara me ligj gjegjësisht me Udhëzimin administrativ dhe kërkoj nga drejtoresha që ekskursionet të mos lejohen sipas dëshirave të nxënësve sepse ata janë të papjekur ndërsa ne mbajmë përgjegjësi për ata.

Salih Hoti – kërkoj që DKA së bashku me kryetarin në mbështetje të KK-së të jetë zbatuese strikt e rregulloreve të punës të arsimit në nivel komunal. Nuk duhet lejuar organizimin e ekskursioneve pa pëlqimin e DKA-së dhe të drejtorit të shkollës dhe ata që tentojnë jashtë shkollave të bëjnë organizime të tilla duhet ndaj tyre të merren masa disiplinore më të rrepta. Sa i përket përjashtimit të nxënësve, këtu ka që po ankohen për të drejtat e fëmijëve, nuk duhet lejuar që shkollat tona që 20-30 nxënës rebel që i bëjnë nga 200-300 mungesa, pinë duhan, fyejnë arsimtarë, përлахen në shkollë me i lejuar që të na prishin Arsimin vetëm për shkak tyre.

Nahit Elshani – kam një pyetje se ka qenë shqetësimi i disa prindërve kur është bërë organizimi i mbërmeve të maturës, ka qenë një çmim rreth 30 € dhe shqetësimi ka qenë pse tërë këto mjete janë kërkuar kur dihet që në restorante është 12 € një ulëse dhe pyetja konkrete është a mbulohen shpenzimet edhe të arsimtarëve që i marrin edhe gratë me veti me ato mjete apo paguajnë vetë arsimtarët.

Rrustem Thaçi – mbërmeja e maturës kushton 30 € sepse 10 € kushton për një kërrigë, paguhet muzika, fotografitë ndërsa kujdestari i klasës shkon pa pagesë.

Smajl Latifi – është informatë për fillimin e vitit të ri shkollor 2011/2012, është mirë që juanë bërë këto pyetje dhe diskutime dhe besoj që drejtoresha ju ka dhënë sqarime. Për sa i përket temës së pezullimit të nxënësve dhe temës së ekskursionit po ashtu u dhanë sqarimet. Të harojnë ata që pretendojnë të përfitojnë në kurriz të nxënësve sepse tani e tutje do të ndëshkohen edhe me forcën e pushtetit kushtojnë që tenton të përfitojë në kurriz të nxënësve materialisht apo në forma tjera. Unë kam mundur me përdor edhe forcën e pushtetit dhe me i arrestua disa njerëz për të cilët kemi informata, por nuk jemi njerëz të sigurisë. Ju kisha lutur që ndërhyrjet në shkollë nga elementi jashtë shkollës për përfitime personale, jo që janë të ndaluara me ligj, por ne nuk do t'iu lëmë mundësi tani e tutje.

Feim Fetoshi – e dëgjova me vëmendje drejtoreshën në përgjigjen e dy pyetjeve të mia, por para kësaj dua të falënderoj publikisht kryetarin e Komunës kur thotë që kanë me pushue të gjithë ata që kanë përfituar prej nxënësve në shkolla dhe pikërisht këtu është brenga ime sepse i nderuar kryetar informatat janë shumë të sakta që atë ekskursion kur e keni anuluar keni bërë mirë dhe unë pajtohem

absolutisht që çdo gjë të shkoj sipas rregullave. Nuk di që ka njeri që insiston me shkue ekskursionet jashtë institucioneve, por informatat janë shumë të sakta dhe nuk e di a i keni ju këto informata. Drejtoresha në fillim ka bërë kalkulime me nxënës që mënyrë që ti qojë ata, kur ata nuk e kanë pranuar ofertën e tyre atëherë ka ardhur tek ju dhe ju ka treguar që nuk është mirë me shku dhe ju keni bërë drejt. Tjetër, zonja drejtoreshë e tha këtu që nuk është e vërtetë që nuk është pranuar kunata. Po ju pyes direkt nëse kjo kunatë në fillim të këtij viti shkollor nuk ka ardhur në shkollë, në gjimnaz, nuk është prezantuar para nxënësve dhe nuk ka mbajtur disa orë dhe pastaj pas disa intervenimeve nuk e keni heqë ju, unë publikisht para këtij Kuvendi kërkoj falje. Por kjo informatë është shumë e sigurt. Ajo ka ardh, është prezantuar para nxënësve, ka mbajtur disa orë, por keni parë reagimet e keni tërheqë. Tjetra, më vjen mirë që pjesërisht e pranuat që kërkesa e nxënësve, pra, qenka legjitime, nëse nxënësit financojnë 100% nga buxheti i tyre, çka ka kundër ligjit që ata me marr pjesë në hapjen e tenderëve dhe të shohin se kush po ofron kushte më të mira. Nuk ka ligj, nuk ka normë morale e as ligjore që të ndaloj këtë. Diç tjetër do të ishte sikur ju të organizoni me mjetet e juaja. Pra, ata 100% paguajnë dhe nuk kërkojnë asgjë më tepër, organizimin ju e keni, por kërkojnë të marrin pjesë në hapje, sepse i kanë dyshimet se po keqpërdoret djersa e tyre.

Besa Hoxha-Beqiri – sa i përket ekskursionit unë edhe paraprakisht e thasë që nxënësit, përfaqësuesit e maturantëve në çdo shkollë e ka kryetarin e vet. Publikisht po ju them që do të marrin pjesë në hapje të ofertave dhe do të marrin pjesë në vendim që do të vendoset për ekskursion. Sa i përket kunatës së drejtoreshës është e vërtetë që ajo një ditë ka shkuar atje, por pa informim timin. Është problem se ne numrin e mësimdhënësve në shkolla të mesme e kemi të kufizuar dhe jemi të detyruar që mësimdhënës që janë në lista të shkollave fillore nuk kanë normë të plotë, bëjnë plotësim të orëve të tyre në shkollat e mesme. Ky rast është shfrytëzuar në atë shkollë dhe është dërguar. Në momentin që e kam kuptuar, brenda ditës nga drejtori i shkollës fillore që punëtori i tij ka orë aty e në shkollën tjetër, unë e kam thirr në bisedë drejtoreshën dhe i kam thënë që nuk mund të bëhet pikërisht për shkak të familjarizimit dhe nuk e kam lejuar ndërsa nuk është fare e vërtetë që unë e kam dërguar.

Labinot Berisha – kërkoj nga drejtoresha që për nxënësit e suspenduar deri më 12 shkurt me emër dhe mbiemër dhe rrjedhjen për secilin nxënës për një vit të shkollës. Nuk dëshiroj të replikoj me Salihun, por dëshiroj të përmendi që aty ku ka shkelje e të drejtave të njeriut çdokujt i them se nuk është ashtu. Në rastin e fëmijëve ju i quaj të rrugaç, neve mund të na krijohen edhe 40 rrugaç tjerë me këtë fjalor të juaj por sistemi i ka krijuar ata rrugaç dhe e dyta për çështjen e maturës, jam i pa kontestuar në rastin e fshatit Ratkoc dhe nxënësit nuk guxon të trajtohen si të Ratkocit sepse janë nxënës e të gjitha atyre lokaliteteve. Kur janë organizuar ata të rinj ka qenë jashtë objektit të shkollës, ka qenë jashtë organizimit të shkollës dhe është e drejtë e tyre të organizohen në kuadër të shoqërisë civile. Atë ditë ndërhyrja e institucioneve të Komunës ka qenë shumë e vrazhdë dhe lexoni Ligjin për asociacionet për shoqërinë civile dhe do të shihni se a kanë të drejtë të rinjtë të organizohen në aktivitete të tilla.

Avdullah Kryeziu – e dëgjova informatën e drejtoreshës në fillim dhe më bëri përshtypje që DKA-ja ka përfituar donacione diku rreth 770.000 € dhe kjo është inkurajuese për Kuvendin komunal dhe për DKA-në, mirëpo kam përshtypje se në shkollat fillore në Rahovec të cilat i kam vizituar, kam parë kaos në ato shkolla, kam parë kërrigë dhe banka të thyera dhe në këtë drejtim desha të pyes se a janë pajisur shkollat me kërrigë dhe banka të reja. Sa i përket çështjes së ekskursionit z.kryetar ju nuk keni të drejt të përziheni në ofertat të cilat nuk i paguani ju por nxënësit dhe ata le të zgjedhin operatorin ekonomik e jo Kuvendi komunal ose dikush tjetër. Kam edhe një informatë jozyrtare se uniformat për nxënësit të shkollës fillore blihen nga 3 € ndërsa nxënësit i shitet nga 7 € dhe dhashë Zoti nuk është e saktë.

Besa Hoxha-Beqiri – është e vërtetë që është fituar donacion prej 779.951 € prej të cilave janë, 220.000 janë fituar për investime kapitale për projektet e parapara të vitit të kaluar. Pikërisht kjo shumë e mjeteve përveç atyre plotësimeve që duhet të bëhen, 70.000 janë për nxehje qendrore në “Isa Boletini” dhe 150.000 për ndërtimin e Shkollës fillore në Gur të Kuq. Me 220.000 € do të bëhet ridestini i tyre me aprovimin e Kuvendit komunal ndër të cilat është edhe inventari shkollor. Ne nuk kemi përkrahje të Ministrisë, është bërë kërkesa për shkak se jemi në gjendje shumë të keqe me inventar, banka dhe kërrigë, është fakt që nuk ruhen në njërën anë dhe në anën tjetër kemi inventar të vjetruar në disa shkolla dhe kemi nevojë t’i furnizojmë. Prandaj shpresoj që me anë të ridestinitimit do

të bëhet e mundshme që një pjesë e tyre të furnizohen me banka dhe kërrigë të reja. Sa i përket ekskursioneve me Udhëzim administrativ nuk parashihet që nxënësit të jenë pjesë e hapjes së ofertave, mirëpo pasi që është kërkesa dhe mendohet që mund të largohet manipulimi në atë mënyrë pa kurrfarë problemi do të kemi edhe prezencën e tyre në hapjen e ofertave për ekskursion. Për sa i përket uniformave nuk kam informatë për një gjë të tillë.

Rukije Krasniqi – sa i përket uniformave për nxënës të shkollave ende nuk kemi ngase unë jam vetë punëtore e arsimit dhe nuk kemi informacion lidhur me pagesën e uniformave të nxënësve nëpër shkolla.

5. Shqyrtimi i kërkesës së Fadil dhe Milaim Musli Paçarizi nga Rahoveci për dhënie në shfrytëzim të një pjesë të ngastrës ndërtimore nr. 1355/4 në pronësinë shtetërore.

Kyesuesi – për këtë pikë kemi diskutuar edhe në mbledhjen e KPF dhe kemi të bëjmë me një parcelë 48 m2 dhe kemi vendosur që si anëtarë të KPF të vizitojmë gjendjen faktike në terren gjë që edhe kemi bërë. Familja është në gjendje të rëndë ekonomike, janë 12 anëtarë të familjes dhe prona që kërkohet nuk është ndonjë vend strategjik por është pronë në mesin e shtëpive.

Elhami Zhuniqi – kjo është një familje e varfër e meqë ka të bëjë me një sipërfaqe shumë të vogël dhe nëse nuk ka probleme pronësore juridike kjo kërkesë të aprovohet dhe kësaj familje t'i dalim në ndihmë.

Feim Fetoshi – të vobektit duhet ti ndihmojmë aq sa mundemi, por nëse ndodh që këta persona pas disa vitesh pasurohen çka do të bëhet me këtë pronë të Komunës, a ekziston ndonjë aneks juridik që ata në aspektin vullnetar me e kthye këtë ndihmë apo jo.

Rasim Fazliu – ne kemi vizituar këtë familje e cila ishte mjaft e varfër, nuk ka të bëjë me ndonjë përfitim, prandaj është në pyetje një sipërfaqe shumë e vogël dhe personalisht jam që t'i ndihmohet dhe të aprovohet kjo kërkesë.

Fatmir Iska, drejtor i Drejtorisë për gjeodezi, kadastër dhe pronë – në pronësinë shtetërore 1355/4 është 0.07.70 ha në të cilën sipërfaqet janë ndërtesat e banimit kolektiv ndërsa kërkuesit që posedojnë sipërfaqen është 0.00.57 ha ndërsa tani kërkojnë edhe 0.00.48 ha në shfrytëzim të përhershëm pa të drejtë tjetërsimi.

Kryesuesi pas hedhjes në votim ka konstatuar se njëzëri **APROVOHET** kërkesa e **Fadil dhe Milaim Musli Paçarizi nga Rahoveci për dhënie në shfrytëzim të një pjesë të ngastrës ndërtimore nr. 1355/4 në pronësinë shtetërore.**

6. Shqyrtimi i kërkesës së Adem Hasaj nga Rahoveci për ndarjen në shfrytëzim të ngastrës kadastrale nr. 2240/43 në pronësinë shtetërore.

Kryesuesi – ky person kërkon 3 ari për t'i ndarë në zonën ku Kuvendi i Komunës ka shpallur zonën për ndërtimin e shtëpive skamnorëve, mirëpo prej asaj kohe ai komision nuk funksionon dhe kemi lënë që kjo çështje të diskutohet në Kuvend.

Nahit Elshani – edhe vitin e kaluar kemi pasur kërkesa të tilla dhe kemi thënë që Kuvendi i Komunës duhet të shpall konkurs për ndarjen e trojeve qytetarëve nevojat dhe Kuvendi i Komunës të formoj Komisionin për ndarjen e trojeve. Konsideroj se nuk mund të ndajmë troje në mënyrë individuale, por këtë të merr përsipër kryetari i Komunës, të shpall konkurs për ndarjen e trojeve në zonën e caktuar për të rastet sociale, por para kësaj është mirë që atyre të cilëve iu janë ndarë troje e të cilët nuk kanë filluar me ndërtim brenda 3 vite që pronën t'i rikthejnë Komunës. Duhet së pari të shihet sa shtëpi janë ndërtuar dhe të gjitha pronat tjera të cilat nuk janë shfrytëzuar për atë qëllim t'i kthehen komunës sepse ata nuk kanë pasur nevojë por i kanë marr për çështje tjera.

Labinot Berisha – pajtohem me rekomandimin e parafolësit, por 7-8 vite kur është bërë një petition nga fshati për t'i dhënë një familje 4 ari truall në fshat dhe atë kohë fshati i pat thënë me arsye që atëherë kur ti nuk je nevojtarë për këtë shpi e njëjta i dhurohet fshatit dhe ai i ka dërguar një institucioni fetar çelësat e jo fshatit, që nuk jam kundër, mirëpo ka futë një përçarje goxha të thellë në mes të banorëve të fshatit. Unë jam pro këtyre rasteve por duhet të jemi vigjilent dhe duhet të bëhet një marrëveshje për një afat të caktuar dhe kur konsiderohet se nuk ka gjendje të rëndë sociale, atëherë që ai sigurisht duhet të lëshoj atë shtëpi që të shfrytëzohet për nevojat e rastit tjetër social sepse ne si kemi filluar çdo seancë duke dhënë prona për biznese, për raste sociale, mendoj që brenda mandatit tonë do të përfundojmë me pronat publike me ato çka kanë mbetur.

Salih Hoti – kërkesa të tilla mund të kemi edhe në të ardhmen dhe Komisioni që del me i verifikuar rastet e tilla ekskluzivisht miratimi po ose jo varet nga Komisioni se a kanë parë gjendjen objektivisht apo jo. Nëse anëtarët e Komisionit dalin me verifikua në teren një rast të tillë e nuk na bindin me fakte që duhet me ja nda, mendoj që nuk është mirë në atë formë. Rastet që i kemi dhënë në vitin 2003 nga KK-ja për ndërtime të tilla e në ato parcela nuk është ndërtuar asgjë, Komuna t'i rikthejë ato troje, ndërsa për këtë rast pa dal komisioni në vendin e ngjarjes, do të abstenoj.

Rasim Fazliu – duhet së pari të shpallet konkursi për ndarjen e trojeve dhe të formohet Komisioni për ndarjen e trojeve.

Rukije Krasniqi – nëse formohet Komisioni paraprakisht të caktohen edhe kriteret dhe kushtet të cilat duhet të plotësojnë kandidatët të cilët kërkojnë troje për ndërtimin e shtëpisë.

Me një abstencion është **vendos** që kryetari të **formoj Komisionin** dhe të përcaktohen kriteret dhe kushtet për ndarjen e trojeve skamnorëve të Komunës së Rahovecit.

7.Pyetjet e këshilltarëve nga mbledhja e 12.09.2011:

- **Burim Krasniqi** – gjatë diskutimit z.Esad Haxhijaha ka cekur se ka probleme pronësore si rasti i dy rahovecianëve që nuk mund të shfrytëzojnë pronat e veta në Xërxe për shkak presioneve. Është Firma “Fetoshi” Fortesë, “Zeni commerce” Fortesë, “Korenica” Rahovec, “Matrexi”, “Agoni” Rahovec, “Zyberaj” Drenoc, ka të vendeve të ndryshme që bëjnë biznes në Xërxe dhe asnjëherë nuk ka pasur probleme. Kërkoj prej kryetarit të Komunës që të pyes z.Esad Haxhijaha se kush janë ata njerëz që e pengon dikë që të kryej veprimtarinë në Xërxë dhe të ndërmerren masa ndaj atyre personave.

- z.Mahmut S. Kryeziu nga Xërxa me pëlqimin e fshatit ka bërë një kërkesë për ndarjen e truallit për banim në Xërxe ndërsa asnjëherë nuk është paraqitur kërkesa e këtij zotëriu në Kuvendin komunal.

- **Fatmir Kadiri** – për rregullimin e rrugëve fushore është ndarë një buxhet nga ky Kuvend por unë kam kërkesë që në Kornizën Afatmesme Buxhetore që të hapet kodi për hapjen e rrugëve të reja fushore, duke qitur se në fshatin nga vijë unë ka probleme të mëdha të rrugëve fushore.

- **Avdullah Kryeziu** – një kërkesë nga data 15.02.2011 e cila i është drejtuar drejtpërdrejtë kryetarit të Komunës nga banorët e Lagjes “Xhevat dhe Alajdin Elshani” me 40 nënshkrime dhe deri më tani nuk kemi marr përgjigje dhe ajo kërkesë nuk është futë në prioritet dhe në buxhet. Këtë kërkesë do t’ju dorëzoj edhe njëherë dhe me siguri do të shqyrtoni dhe me stafin e juaj do të bisedoni për këtë çështje.

- **Nahit Elshani** – problemi ka të bëjë me një gyp të ujit që ne në bashkëfinancim me Komunën e kemi vendos prej Brestocit deri te mulliri në Rahovec dhe në gjatësi prej 700 metra gypi ka mbetur pa u përfunduar, por kemi problem edhe me furnizim të ujit, ndërsa ajo që është më shqetësuese për momentin se gypi është i dëmtuar dhe në momentin që ndalet uji, hyjnë edhe ujërat e zeza në të dhe banorët e asaj lagje rrezikohen sa herë që të ndalet uji. Po ashtu është i dëmtuar edhe vetë sistemi i “Radoniqit” për faktin se aty çdo herë kur rritet presioni ujit, ata që kalojnë për Krushë të Madhe shohin se asfalti ka filluar të dëmtohet ndërsa dimrit do të prishet tërësisht sepse qarkullojnë edhe ujërat e zeza dhe uji i pijes nëpër sipërfaqet e asfaltit. Është mirë që të gjenden mjetet dhe mundësitë që ajo punë të kryhet në këtë vit, të ndërrohet ai gyp për faktin se është në pyetje është shëndeti i banorëve të fshatit.

- **Rukije Krasniqi** – kam një kërkesë për inventar shkollor të Sh.F. “Isa Boletini” ku frekuentojnë rreth 1.200 nxënës, që për punë më cilësore dhe suksese më të larta është i domosdoshëm edhe një projektor, meqenëse shumica e shkollave kanë projektorë.

- Vërehet mungesa në aspektin e ofritit të shërbimeve në lëmin e barnave sepse në orët e vona të mbrëmjes pacientët nuk mund të shërbehen me barnat pasi që barnatorja e QKMF nuk punon në dy ndërrime kurse barnatoret private përfundojnë orarin e punës gjatë orëve të mbrëmjes. **Propozoj që Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale të kërkoj nga barnatoret private që të kujdestarojnë gjatë natës ndërsa Barnatorja publike të punoj në dy ndërrime si dhe të përfshihen në kujdestarinë e natës.**

- Mungon ndriçimi publik në qytetin e Rahovecit duhet të funksionalizohet që të ketë ndriçim publik në qytet.

Mbledhja ka përfunduar në ora 17,30.

K r y e s u e s i,
Kujtim Popaj